



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I ZHVILLIMEVE MAKROEKONOMIKE

Numër | **4**
Prill | **2016**

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike

Numër 4

BOTUES Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ©
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Stabilitetit Financiar
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 243
Fax: ++381 38 243 763

FAQJA E INTERNETIT www.bqk-kos.org

ADRESA ELEKTRONIKE economic.analysis@bqk-kos.org;

KRYEREDAKTOR Arben MUSTAFA

AUTORË Zana GJOCAJ
Bejtush KIÇMARI

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHTOJCA STATISTIKORE: Departamenti i Statistikave

VËREJTJE: Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2016),
Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike Nr. 4, Prishtinë.
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

SHKURTESAT

ALL	Leku Shqiptar (<i>angl: Albanian Lek</i>)
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Shtetet e Evropës Juglindore (<i>angl: Central European Free Trade Agreement</i>)
CHF	Franku Zvicerran (<i>angl: Swiss Frank</i>)
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumatorit (<i>angl: Consumer Price Index</i>)
DST	Drejatat Speciale të Tërheqjes
EJL	Evropa Juglindore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian mbi Sundimin e Ligjit (<i>angl: European Union Rule of Law Mission</i>)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFO	Instituti për Hulumtime Ekonomike
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (<i>angl: Import Price Index</i>)
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (<i>angl: Import Price Index</i>)
KFOR	Forca Ushtarake e NATO-së në Kosovë (<i>angl: NATO-led Kosovo Force</i>)
MKD	Denari Maqedon (<i>angl: Macedonian Denar</i>)
NPL	Kreditë jo Përformuese (<i>angl: Non-performing Loans</i>)
OPEC	Organizata e Vendeve për Eksportin e Naftës (<i>angl: Organization of Petroleum Exporting Countries</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PNI	Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve
PPI	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (<i>angl: Producer Price Index</i>)
REER	Norma Reale Efektive e Këmbimit (<i>angl: Real Effective Exchange Rate</i>)

SIMBOLET KONVENCIONALE STATISTIKORE

"—"	dukuria nuk ekziston
". "	dukuria ekziston, të dhënat nuk janë në dispozicion
"..."	zero ose afër zeros
(e)	e vlerësuar
(p)	preliminare
(r)	e reviduar

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje	11
2. Eurozona	15
3. Ballkani Perëndimor	18
4. Çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare	20
4.1. Çmimet e naftës	20
4.2. Çmimet e arit	21
4.3. Çmimet e metaleve dhe mineraleve	21
4.4. Çmimet e prodhimeve ushqimore	22
5. Ekonomia e Kosovës	23
5.1. Bruto Produkti Vendor	23
5.2. Çmimet	26
5.3. Zhvillimet Sektoriale	30
6. Sektori fiskal	36
6.1. Të hyrat buxhetore	36
6.2. Shpenzimet buxhetore	37
6.3. Borxhi publik	38
7. Sektori bankar	40
8. Sektori i jashtëm	43
8.1. Llogaria rrjedhëse dhe llogaria kapitale	43
8.2. Llogaria financiare	51
8.3. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve	54
8.4. Borxhi i jashtëm	56
9. Parashikimet makroekonomike për vitin 2016	58
9.1. Bruto produkti vendor	58
9.2. Sektori fiskal	59
9.3. Sektori bankar	60
9.4. Sektori i jashtëm	60
10. Shtojca statistikore	63
11. Referencat	82

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Shkalla e inflacionit në eurozonë-----	16
Figura 2. Norma e këmbimit të euros ndaj valutave tjera të mëdha-----	17
Figura 3. Shkalla mesatare e inflacionit në Ballkanin Perëndimor-----	18
Figura 4. Çmimii naftës 'brent crude' -----	20
Figura 5. Çmimi i arit, në USD për unce -----	21
Figura 6. Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve -----	21
Figura 7. Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe indeksi i çmimeve të drithrave -----	22
Figura 8. Norma reale e rritjes së BPV-së-----	23
Figura 9. Struktura e komponentëve të BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve -----	24
Figura 10. Komponentët e BPV-së, sipas aktivitetit ekonomik -----	25
Figura 11. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij -----	26
Figura 12. Çmimet e shërbimeve -----	26
Figura 13. Indeksi i çmimeve të duhanit dhe akciza në duhan -----	27
Figura 14. Çmimet e ushqimit -----	27
Figura 15. Çmimet e strehimit, ujit dhe energjisë -----	27
Figura 16. Indeksi i çmimit të energjisë dhe çmimi për KWh-----	28
Figura 17. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë -----	28
Figura 18. Pjesmarrja e komponentëve të tregtueshëm dhe të patregtueshëm në IÇK -----	29
Figura 19. Indekset e komponentëve të tregtueshëm dhe të patregtueshëm -----	29
Figura 20. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit -----	30
Figura 21. Prodhimi, konsumi dhe bilanci i energjisë -----	31
Figura 22. Konsumi i energjisë sipas përdoruesit të fundit -----	31
Figura 23. Transporti hekurudhorë në Kosovë -----	32
Figura 24. Transporti ajror në Kosovë-----	32
Figura 25. Indeksi i qarkullimit industrial -----	32
Figura 26. Regjistri i bizneseve -----	33
Figura 27. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	33
Figura 28. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore -----	34
Figura 29. Shkalla e punësimit -----	34
Figura 30. Shkalla e papunësisë-----	35
Figura 31. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore -----	36
Figura 32. Struktura e të hyrave buxhetore -----	36
Figura 33. Të hyrat vendore neto sipas llojeve kryesore të tatimeve -----	37

Figura 34. Të hyrat kufitare neto sipas llojeve të tatimeve -----	37
Figura 35. Struktura e shpenzimeve buxhetore -----	38
Figura 36. Borxhi publik -----	38
Figura 37. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve -----	40
Figura 38. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik -----	41
Figura 39. Mesatarja vjetore e normave të interesit -----	41
Figura 40. Treguesit e profitabilitetit -----	42
Figura 41. NPL-të dhe provizionet -----	42
Figura 42. Bilanci i llogarisë rrjedhëse -----	43
Figura 43. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar -----	44
Figura 44. Struktura e eksporteve sipas kategorive -----	45
Figura 45. Gjithsej importet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit -----	45
Figura 46. Struktura e importeve sipas kategorive -----	45
Figura 47. Struktura e importeve sipas klasifikimit BEC -----	46
Figura 48. Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve -----	46
Figura 49. Struktura e neto eksportit të shërbimeve -----	47
Figura 50. Shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit -----	48
Figura 51. Të ardhurat parësore -----	49
Figura 52. Të ardhurat dytësore -----	50
Figura 53. Pranimet e remitencave -----	50
Figura 54. Struktura e remitencave sipas shteteve -----	50
Figura 55. Investimet e huaja direkte -----	51
Figura 56. Struktura e IHD-ve sipas aktiviteteve kryesore ekonomike -----	52
Figura 57. IHD sipas aktiviteteve kryesore ekonomike -----	52
Figura 58. Investimet e huaja direkte sipas formës së investimit -----	52
Figura 59. IHD sipas shteteve kryesore -----	53
Figura 60. Asetet e investimeve portfolio, -----	53
Figura 61. Kreditë tregtare dhe importet -----	54
Figura 62. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve -----	54
Figura 63. Stoku i aseteve sipas llojit të investimit -----	55
Figura 64. Stoku i detyrimeve sipas llojit të investimit -----	55
Figura 65. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional -----	55
Figura 66. Borxhi i jashtëm bruto -----	56
Figura 67. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve -----	56

Figura 68. Rritja reale e BPV-së, kërkesa e brendshme dhe e jashtme -----	58
Figura 69. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit në rritje -----	58
Figura 70. Të hyrat dhe shpenzimet primare buxhetore -----	59
Figura 71. Norma e rritjes së kredive dhe BPV-së reale -----	60
Figura 72. Norma e rritjes së depozitave dhe BPV-së reale -----	60
Figura 73. Llogaria rrjedhëse -----	60
Figura 74. Eksporti dhe importii mallrave -----	61

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së -----	15
Tabela 2. Rritja reale vjetore e BPV-së në vendet e Ballkanit Perëndimor -----	18
Tabela 3. Struktura e IÇK-së -----	29
Tabela 4. Llogaria financiare -----	51

1. Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik global është rikuperuar gjatë vitit 2015, megjithëse me diferenca të dukshme në mes të rajoneve. Vendet e zhvilluara u karakterizuan me zgjerim të aktivitetit ekonomik, përderisa vendet në zhvillim u përballën me ngadalësim të ritmit të rritjes ekonomike.

Në vitin 2015, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka vlerësuar se rritja mesatare e BPV-së në eurozonë ishte 1.5 përqind (0.9 përqind në vitin 2014), përderisa për vitin 2016, rritja ekonomike është projektuar të jetë rreth 1.6 përqind. Gjatë vitit 2015, rritja ekonomike në eurozonë është mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme, që mund ti atribuohet kryesisht ndikimit pozitiv që kishin masat e programit të lehtësimit sasior të ndërmarrë nga Banka Qendrore Evropiane (BQE). Gjithashtu, çmimet e ulëta të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, që mbretëruan gjatë gjithë vitit 2015, janë përkthyer në rritjen e të ardhurave të disponueshme të konsumatorëve dhe rritjen e profitabilitetit të firmave, duke nxitur kështu rritjen graduale të investimeve në eurozonë.

Përforcimi i kërkesës së brendshme në eurozonë gjatë vitit 2015 është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve në Ballkanin Perëndimor. Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti ekonomik në këtë rajon u karakterizua me rritje, mbështetur kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme dhe përforcimi i kërkesës së jashtme. Në vitin 2015, rritja reale e BPV-së në Ballkanin Perëndimor vlerësohet të ketë qenë rreth 2.4 përqind, përderisa për vitin 2016, FMN-ja parashikon një përshpejtim të rritjes mesatare të BPV-së në 3.2 përqind.

Niveli i ulët i çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare, si dhe dobësimi i kërkesës në vendet në zhvillim u reflektua në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në nivel global. Sipas FMN-së, shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë në vitin 2015 ishte 0.2 përqind, ndërkohë që parashikimi për vitin 2016 qëndron në 1.0 përqind. Ngjashëm me eurozonën, çmimet e ulëta të naftës, energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare ndikuan edhe në nivelin e çmimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku norma mesatare e inflacionit, vlerësohet të ketë qenë 0.9 përqind. Për vitin 2016, për vendet në Ballkanin Perëndimor, FMN-ja ka parashikuar një rritje të normës mesatare të inflacionit në 1.7 përqind.

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me zgjerim të aktivitetit gjatë vitit 2015 kundrejt vitit paraprak. Sipas vlerësimit të bërë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për tre kuartalet e parë të vitit 2015, vlera nominale e BPV-së në nëntë muajt e parë të vitit 2015 arriti në 4.25 miliard euro, që në terma real, përkon me një rritje mesatare vjetore prej 3.6 përqind. Aktiviteti i përgjithshëm në vend u mbështet kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme, përderisa neto eksportet ndikuan negativisht në normën e rritjes ekonomike. Në kuadër të kërkesës së brendshme, rritja reale e ekonomisë së vendit në nëntë muajt e parë të vitit 2015 vlerësohet të jetë rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve private, përderisa konsumi publik dhe investimet publike vlerësohet të kenë shënuar rënie. Rritja e kreditimit bankar si dhe rritja e flukseve hyrëse të transfereve nga jashtë në formë të remitencave dhe kompenzimit të punëtorëve rezultuan në rritjen e konsumit privat gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015. Gjithashtu, rritja e pagave dhe pensioneve të sektorit publik në vend kishte efekt të plotë në vitin 2015, gjë që rezultoi në rritjen e të ardhurave të disponueshme në ekonomi. Në të njëjtën periudhë, rritja e IHD-ve dhe kredive të reja investuese ndikuan në përforcimin e pozicionit të investimeve private. Sipas qasjes së prodhimit, rritja ekonomike gjatë vitit 2015 ishte kryesisht rezultat i rritjes së vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin e ndërtimitarisë, bujqësisë dhe

furnizimit me energji elektrike. Për tërë vitin 2015, vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes së BPV-së ishte 3.0 përqind.

Zhvillimet sektoriale gjatë vitit 2015 tregojnë për një përmirësim të performancës në sektorin e energjisë. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, prodhimi i energjisë në termocentrale shënoi një rritje vjetore prej rreth 7 përqind, përderisa konsumi i energjisë shënoi një rritje vjetore prej rreth 6 përqind. Rritja e konsumit të energjisë elektrike deri në shtator 2015 është mbuluar kryesisht nga rritja e energjisë së prodhuar në vend, përderisa importi i energjisë elektrike u karakterizua me rënie. Sa i përket sektorit të transportit, transporti hekurudhor vlerësohet të ketë shënuar rënie, si në kuadër të pasagjerëve që kanë shfrytëzuar transportin hekurudhor ashtu edhe në kuadër të mallrave të transportuara përmes hekurudhave. Në anën tjetër, transporti ajror është karakterizuar me rritje të numrit të udhëtarëve dhe numrit të fluturimeve në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Në kuadër të industrisë, të dhënat e indeksit për qarkullimin industrial tregojnë për rënie të qarkullimit në sektorin e industrisë nxjerrëse, ndërkaq rritje të qarkullimit në sektorin e industrisë përpunuese.

Në linjë me zhvillimet në tregjet e jashtme, e veçanërisht me nivelin e çmimeve në eurozonë dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, ekonomia e Kosovës u karakterizua me rënie të nivelit të çmimeve në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), deri në shtator 2015 ishte -0.6 përqind (0.5 përqind deri në shtator 2014). Kontributin kryesor në rënie të nivelit të përgjithshëm të çmimeve në Kosovë në këtë periudhë e kishte rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit, që kryesisht është rrjedhojë e rënies së çmimeve të naftës.

Shkalla e papunësisë në vend ka shënuar rritje në vitin 2014, duke arritur në 35.3 përqind nga 30 përqind në vitin 2013. Në vitin 2014, të rinjtë kishin dy herë më shumë gjasa të jenë të papunë krahasuar me të rriturit, përderisa rreth 61 përqind e popullsisë së re ishte e papunë. Përqindja e të rinjve (15-24 vjeç) të papunë në papunësinë e përgjithshme ishte 28.5 përqind në vitin 2014.

Zhvillimet në sektorin fiskal gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015 tregojnë për një rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Rritja e të hyrave buxhetore për 7.9 përqind dhe rritja e shpenzimeve buxhetore për 6.1 përqind rezultuan në një suficit të përgjithshëm të Buxhetit të Kosovës prej rreth 0.8 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 14.8 milionë euro të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Sa i përket strukturës së të hyrave buxhetore, deri në shtator 2015, të hyrat tatimore u karakterizuan me rritje si rezultat i rritjes së të dy kategorive, të hyrave nga tatimet kufitare dhe të hyrave të mbledhura nga tatimet vendore. Në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, shpenzimet rrjedhëse (pagat e mëditjet, mallrat e shërbimet dhe subvencionet e transferet) u karakterizuan me një rritje vjetore prej 9.1 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për investime kapitale shënuan rënie vjetore prej 4.2 përqind.

Ekonomia e vendit vazhdon të ballafaqohet me disekuilibër kundrejt sektorit të jashtëm. Përderisa vlera e shtuar nga sektorët prodhues në vend mbetet e ulët, rritja e kërkesës së brendshme çon në rritje të mëtejme të importit. Rritja e konsumit dhe investimeve në nëntë muajt e parë 2015 ka ndikuar në rritjen e importit në vend, gjë që është përkthyer në rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse. Gjithashtu, me rënie u karakterizuan edhe bilancet pozitive në llogarinë e shërbimeve dhe të ardhurave parësore, përderisa bilanci pozitiv i të ardhurave dytësore shënoi rritje. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka arritur në 308.2 milionë euro apo rreth 7 përqind të BPV-së deri në shtator 2015, nga rreth 6.7 përqind sa ishte në periudhën e

njëjtë të vitit paraprak. Në këtë periudhë, deficitin në llogarinë e mallrave shënoi rritje vjetore prej 2.5 përqind, duke arritur vlerën prej 1.7 miliard euro. Vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në nëntë muajt e parë të vitit 2015 shënoi një rritje vjetore prej 5.3 përqind, përderisa vlera e gjithsej mallrave dhe shërbimeve të importuara shënoi një rritje prej rreth 2.6 përqind. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, arritën vlerën prej 568.8 milionë euro në shtator 2015, që paraqet një rritje vjetore prej 12.5 përqind.

Në kuadër të llogarisë financiare, IHD-të e pranuar në Kosovë u karakterizuan me një rritje të theksuar në nëntë muajt e parë të vitit 2015 kundrejt vitit paraprak. Deri në shtator 2015, IHD-të e pranuar në vend arritën vlerën prej 270.4 milionë euro, gjegjësisht 148.6 milionë euro më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2014. Rritja e theksuar e pozicionit të IHD-ve gjatë vitit 2015 i atribuohet fluksit më të lartë hyrës të IHD-ve krahasuar me vitin paraprak, por edhe efektit të bazës duke qenë se viti 2014 ishte viti me nivelin më të ulët të IHD-ve të regjistruar në vitet e fundit. Në Kosovë, IHD-të janë kryesisht të përqendruara në sektorët e ekonomisë si patundshmëria, ndërtimtaria, shërbimet financiare, transport dhe komunikim, dhe energjetikë. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, pothuajse të gjithë sektorët kanë shënuar rritje sa i përket pranimet të IHD-ve. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, sektorët që shënuan rritjen më të lartë të IHD-ve të pranuar në vend ishin sektori i patundshmërisë, sektori financiar, ndërtimi dhe industria. Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD gjatë periudhës janar-shtator 2015 (61.5 milionë euro), pasuar nga Turqia (49.4 milionë euro), Mbretëria e Bashkuar (32.7 milionë euro), Shqipëria (28.8 milionë euro), Sllovenia (25.3 milionë euro), Gjermania (20.8 milionë euro), etj. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, investimet portfolio jashtë vendit arritën vlerën prej 54.0 milionë euro (112.7 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2014). Në vitet e fundit, është vënë re një rënie e investimeve portfolio jashtë ekonomisë së vendit, gjë që ndërlidhet me investimet e një pjese të kursimeve pensionale në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Deri në shtator 2015, borxhi i jashtëm i Kosovës (borxhi i jashtëm privat dhe borxhi i jashtëm publik), arriti në 1.9 miliardë euro, që është për 12.3 përqind më i lartë se sa në shtator 2014. Si përqindje e BPV-së, borxhi i jashtëm bruto arriti në 33.2 përqind. Borxhi i jashtëm publik në shtator 2015 kishte vlerën prej 436.8 milionë euro, një pjesëmarrje prej 22.8 përqind në gjithsej borxhin e jashtëm bruto. Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm përbëhet nga huatë ndërmjet kompanive. Në strukturën e borxhit të jashtëm, FMN ka një pjesëmarrje prej 10.3 përqind, pasuar nga Banka Botërore që ka një pjesëmarrje prej 10.9 përqind, si dhe kreditorët tjerë (më shumë se gjysma e borxhit ndaj kreditorëve tjerë është kreditim ndërmjet kompanive) që kanë një pjesëmarrje dominuese prej 78.9 përqind.

Stoku i borxhit publik arriti vlerën prej 719.5 milionë euro në shtator 2015, një rritje kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak prej 30.6 përqind. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 12.5 përqind (10.2 përqind në shtator 2014), që tregon për një shkallë ende të ulët të borxhit publik në Kosovë kur kemi parasysh rregullën fiskale që përcakton kufirin maksimal të borxhit të përgjithshëm publik në 40 përqind të BPV-së. Në shtator 2015, rreth 51.0 përqind e gjithsej borxhit publik ishte borxh ndërkombëtar (FMN-së dhe Bankës Botërore). Pjesa tjetër prej 49.0 përqind e borxhit publik është borxh i brendshëm, që kryesisht përbëhet nga borxhi i qeverisë ndaj bankave komerciale dhe fondeve pensionale. Deri në shtator 2015, borxhi i brendshëm publik u karakterizua me një rritje vjetore prej 51 përqind, përderisa borxhi i jashtëm publik shënoi rritje vjetore prej 15.6 përqind.

Sistemi financiar i Kosovës gjatë vitit 2015 është karakterizuar me zgjerim të aktivitetit dhe nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Dinamika e aktivitetit kreditues në vend vlerësohet të ketë qenë në nivelin më të lartë në tri vitet e fundit. Në shtator të vitit 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.0 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.5 përqind. Ndikim të rëndësishëm në përshpejtimin e rritjes së aktivitetit kreditues ka pasur lehtësimi i standardeve kreditore dhe përmirësimi i kushteve të kreditimit nga ana e bankave, përderisa edhe kërkesa për kredi ka shënuar rritje. Megjithatë, përkundër ritmit të përshpejtuar të rritjes së kreditimit, raporti i kredive të sektorit bankar ndaj BPV-së në vitin 2015 ishte rreth 35 përqind, që është më i ulët se sa mesatarja e vendeve të rajonit që qëndroi në rreth 48 përqind. Kjo sugjeron se, në raport me madhësinë e ekonomisë, vazhdon të ketë hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditor nga sektori bankar. Struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, përderisa sektorë të rëndësishëm siç janë prodhimi dhe bujqësia kanë pjesëmarrje të ulët në strukturën e përgjithshme të portfolios kreditore të sektorit bankar. Sidoqoftë, me gjithë pjesëmarrjen e ulët në gjithsej kreditë, sektori i bujqësisë dhe prodhimit u karakterizuan me rritjen më të lartë të kredive prej 17.4 përkatësisht 10.1 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Në këtë periudhë, rritje të kreditimit shënuan edhe sektori i tregtisë dhe energjetikës, përderisa sektori i ndërtimit vazhdoi të karakterizohet me rënie të kreditimit për të tretin vit radhazi. Burimi kryesor i financimit për sektorin bankar vazhdojnë të jenë depozitat, që në shtator 2015 shënuan rritje vjetore prej 5.5 përqind.

Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, përmirësimi i kushteve të kreditimit nga ana e bankave u realizua kryesisht përmes zvogëlimit të theksuar të normës së interesit, gjë që paraqet një lehtësim të rëndësishëm për qasjen individëve dhe ndërmarrjeve në financimin bankar. Norma mesatare e interesit në kredi në shtator 2015 u zvogëluar në 7.9 përqind (10.7 përqind në shtator të vitit 2014). Zvogëlimi i normës së interesit ishte evident për kreditë e destinuar për të gjitha veprimtaritë ekonomike. Rënia më e theksuar e normës mesatare të interesit është shënuar te kreditë për sektorin e shërbimeve (7.4 përqind në shtator 2015 nga 11.2 përqind në shtator 2014), kreditë e sektorit të industrisë (7.4 përqind në shtator 2015 nga 10.3 përqind sa ishte në shtator 2014) si dhe kreditë e sektorit të bujqësisë (9.8 përqind në shtator 2015 nga 11.5 përqind në shtator 2014).

Për vitin 2016, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me një rritje reale të BPV-së prej 3.2 përqind. Rritja reale ekonomike pritet të mbështetet kryesisht në rritjen e konsumit privat, përderisa konsumi publik pritet të mbetet i njëjtë me vitin 2015. Gjithashtu, rritjes së ekonomisë në vitin 2016 pritet ti kontribuojë edhe përforcimi i pozicionit të përgjithshëm të investimeve, si rezultat i rritjes së investimeve publike dhe private. Rritja e kërkesës së brendshme pritet të ndikojë në rritje të importit dhe, rrjedhimisht, në rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse, përkundër pritjeve për rritjen e vlerës së gjithsej eksporteve. Investimet e huaja direkte, si komponenta kryesore e llogarisë financiare në bilancin e pagesave, pritet të karakterizohen me rritje edhe në vitin 2016. Sektori fiskal pritet të karakterizohet me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Për sa i përket sektorit financiar, aktiviteti kredidhënës pritet të vazhdojë trendin e rritjes, duke shërbyer kështu si burim i rëndësishëm i financimit të rritjes ekonomike edhe në vitin 2016.

2. Eurozona

Aktiviteti ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2015 është rikuperuar gradualisht, mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme. Ndërkaq, presionet gjeopolitike dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vendet në zhvillim ndikuan në dobësimin e eksporteve të eurozonës.

Rritja e aktivitetit ekonomik mbeti e koncentruar në ekonomitë qendrore të eurozonës, gjegjësisht në Gjermani, Francë dhe Spanjë, përderisa vendet tjera të eurozonës vazhduan të karakterizohen me rritje të dobët ekonomike (tabela 1). Pas më shumë se dy viteve të rritjes graduale të ekonomive të Eurozonës, norma e rritjes reale të BPV-së në eurozonë është përafëruar me rritjen e shënuar në tremujorin e parë të vitit 2008. Deri në shtator 2015, eurozona u karakterizua me një rritje mesatare vjetore prej 1.4 përqind, kundrejt rritjes më të dobët në periudhën e njëjtë të vitit paraprak prej 0.2 përqind. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, rikuperimi ekonomik në eurozonë vlerësohet të jetë përforcuar, duke u mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme si rezultat i rritjes së konsumit privat. Sektorët që kontribuan më shumë në rritjen reale të ekonomisë në eurozonë gjatë vitit 2015 ishin sektori i prodhimit, sektori i shërbimeve tregtare, të transportit, akomodimit dhe ushqimit, si dhe sektori i shërbimeve profesionale dhe të biznesit. Për vitin 2016, FMN parashikon një rritje reale të ekonomisë së eurozonës prej 1.6 përqind.

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Eurozona	-0.8	-0.3	0.9	1.5
Gjermania	0.6	0.4	1.6	1.5
Franca	0.2	0.7	0.2	1.2
Italia	-2.8	-1.7	-0.4	0.8
Austria	0.8	0.3	0.4	0.8
Spanja	-2.1	-1.2	1.4	3.1
Greqia	-6.6	-3.9	0.8	-2.3

Burimi: WEO (2016)

Ndikim të drejtpërdrejtë në rikuperimin e aktivitetit ekonomik në eurozonë që nga fillimi i vitit 2015 kishte pakvoja e masave të reja të lehtësimit sasior që ndërmori Banka Qendrore Evropiane (BQE). Në mars 2015, BQE filloi programin e lehtësimit sasior, program nën të cilin pritet të realizojë blerje të obligacioneve të qeverive evropiane dhe letrave të tjera me vlerë të institucioneve evropiane në shumën prej 60 miliard euro në muaj. Emetimi i parasë së re në ekonominë evropiane kishte kryesisht synim evitimin e deflacionit dhe rikthimin e normës së inflacionit afër caktit të BQE-së, duke stimuluar kreditimin bankar për bizneset. Që nga tetori i vitit 2014 e deri në dhjetor të vitit 2015, BQE ka blerë rreth 143 miliardë euro obligacione të mbështetura dhe rreth 15 miliard euro asete të mbështetura në letra me vlerë.

Në gjysmën e parë të vitit 2015, pas lansimit të programit të lehtësimit sasior nga BQE-ja, është vënë re një rikuperim i ekonomisë së eurozonës, përderisa zyrtarët e lartë të BQE-së kanë deklaruar se politikat e lehtësuara monetare në mënyrë të vazhdueshme janë plotësuar edhe me politika të planifikuara makroprudenciale për të siguruar mirëmbajtjen e stabilitetit financiar. Politika e lehtësuara monetare është përkthyer në lehtësim të kushteve për kreditim, duke përmirësuar kështu kushtet e të bërit biznes në eurozonë. Lehtësimi i standardeve kreditore, si

dhe rritja e kërkesës për kredi ishte më e theksuar te ekonomitë familjare, megjithëse edhe kreditimi i ndërmarrjeve ka filluar rikuperimin gradual. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, ekonomitë familjare u karakterizuan me një rritje mesatare të kreditimit prej 0.9 përqind (rënie mesatare vjetore prej 0.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014), ku rritja më e lartë e kreditimit u shënuar në tremujorin e tretë të vitit (1.6 përqind). Në anën tjetër, në periudhën raportuese, kreditimi i sektorit privat u karakterizua me një rënie mesatare prej 0.2 përqind, që tregon për një përmirësim të lehtë të kreditimit të sektorit privat krahasuar me vitin paraprak kur sektori privat u karakterizua me rënie mesatare prej 2.5 përqind të kreditimit.


Pozicioni i investimeve në eurozonë vazhdon të jetë dukshëm më i ulët krahasuar me nivelin që kishte para krizës financiare të vitit 2008. Megjithatë, në kuadër të pozicionit të investimeve, gjatë vitit 2015 është shënuar një rritje graduale e aktivitetit në sektorin e ndërtimit, sektor që u karakterizua me rënie që nga fillimi i krizës financiare, përderisa rritje më e theksuar u shënuar në sektorin e makinerisë. Përmirësimi i mëtejme i kushteve të kreditimit, përforcimi i vazhdueshëm i kërkesës dhe rritja e mëtejme e profitabilitetit të firmave, si rezultat i çmimeve më të ulëta të naftës, si dhe përmirësimi i treguesve të tregut të punës, pritët të reflektohen në rritje të investimeve në periudhat në vazhdim.

Rikuperimi ekonomik gjatë vitit 2015 vlerësohet të jetë penguar deri në një masë nga zhvillimet në aktivitetin ekonomik në vendet në zhvillim dhe rritja modeste e tregtisë globale. Vendet në zhvillim u karakterizuan me ngadalësim të rritjes ekonomike në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak (Kina), gjegjësisht rënie ekonomike (Rusia dhe Brazili). Dobësimi i kërkesës së jashtme, rritja e normave të interesit nga SHBA-të dhe rënia e çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare ka ndikuar negativisht në aktivitetin ekonomik të vendeve në zhvillim. Eksportet e eurozonës u ndikuan negativisht nga zhvillimet ekonomike në Brazil, Kinë dhe Rusi. Duke qenë partner të rëndësishëm tregtar të eurozonës, zvogëlimi i kërkesës së jashtme nga këto vende shkaktoi dobësim të pozicionit të neto eksporteve të eurozonës. Megjithatë, rritja e kërkesës nga vendet e zhvilluara si dhe dobësimi i monedhës së euros kundrejt valutave tjera ka neutralizuar deri në një masë ndikimin negativ nga vendet në zhvillim.

Në linjë me pritjet, niveli i çmimeve të naftës gjatë vitit 2015 mbeti i ulët, duke mbështetur rritjen e mëtejme të konsumit privat dhe investimeve përmes rritjes së të ardhurave të disponueshme për ekonomitë familjare dhe rritjes së profitabilitetit të korporatave. Niveli i ulët i çmimeve të naftës vazhdoi të reflektohet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve në eurozonë ku, sipas BQE-së, shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë deri në shtator 2015 ishte -0.03 përqind, krahasuar me 0.5 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2014.

Niveli më i ulët i çmimeve u shënuar në tremujorin e parë të vitit 2015, kur eurozona u karakterizua me deflacion prej rreth 0.3 përqind. Në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2015 eurozona u karakterizua me normë mesatare të inflacionit prej 0.2 përkatësisht 0.0 përqind. Sipas BQE-së, shkalla mesatare vjetore e inflacionit në eurozonë në vitin 2015 ishte 0.0 përqind, përderisa për vitin 2016, BQE ka parashikuar një normë të inflacionit prej 1.0 përqind.

Figura 1. Shkalla e inflacionit në eurozonë, në përqindje




Ngjashëm me BQE-në, edhe FMN ka vlerësuar se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë në vitin 2015 ka qenë 0.2 përqind ndërkohë që parashikimi për vitin 2016 është i njëjtë me eurozonën, gjegjësisht 1.0 përqind (figura 1). Rënia e vazhdueshme e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare në pjesën e mbetur të vitit 2015 dhe fillimin e vitit 2016 ka neutralizuar deri në një masë ndikimin e programit të lehtësimit sasior, duke ndikuar kështu në presione të ulëta inflacioniste dhe rishikim potencial të parashikimeve si për vitin 2016 ashtu edhe për vitin 2017.

Sa i përket sektorit fiskal, në nëntë muajt e parë të vitit 2015, shkalla mesatare e borxhit publik në eurozonë u karakterizua me një rënie të lehtë në mesatarisht 92.3 përqind të BPV-së (92.4 përqind e BPV-së në nëntë muajt e parë të vitit 2014). Shkallën më të lartë të borxhit publik në eurozonë vazhdon ta ketë Greqia (rreth 168 për ind të BPV-së), pasuar nga Italia dhe Portugalia (136 përkatësisht 130 përqind të BPV-së). Në nëntë muajt e parë të vitit 2016, shkalla e llogarisë rrjedhëse të vendeve në eurozonë arriti në mesatarisht 2.7

përqind të BPV-së, nga 1.9 sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Megjithëse gjatë vitit 2015, eksportet e eurozonës u ndikuan negativisht deri në një masë nga zvogëlimi i kërkesës nga ekonomitë e mëdha në zhvillim, në të njëjtën kohë, dobësimi i monedhës së euros u përkthye në rritje të konkurrueshmërisë së mallrave të eurozonës (veçanërisht të Gjermanisë) kundrejt vendeve tjera me të cilat tregton. Gjatë vitit 2015, programi i lehtësimit sasior nga BQE dhe politika e lehtësuar monetare janë përkthyer në dobësimin e monedhës së euros kundrejt valutave kryesore. Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan deri në shtator 2015 u zhvlerësua për 17.9 përqind. Ndaj sterlinës britanike dhe ndaj frankës zvicerane, euro u zhvlerësua për 9.6 përkatësisht 12.9 përqind (figura 2). Sa i përket valutave të vendeve të rajonit, deri në shtator 2015, euro është vlerësuar kundrejt dinarit serb dhe lekut shqiptar për mesatarisht 3.9 përkatësisht 0.1 përqind, përderisa është zhvlerësuar kundrejt kunës kroate për 0.2 përqind.

Figura 2. Norma e këmbimit të euros ndaj valutave kryesore



Burimi: BQK (2016)

3. Ballkani Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në Ballkanin Perëndimor vlerësohet të jetë rikuperuar gjatë vitit 2015 kundrejt vitit paraprak. Në vitin 2015, rritja reale e BPV-së në Ballkanin Perëndimor vlerësohet të ketë qene rreth 2.4 përqind (rreth 1 përqind në vitin 2014). Sipas FMN-së, me rritje më të lartë ekonomike gjatë vitit 2015 u karakterizuan Mali i Zi dhe Maqedonia (3.2 përqind), përderisa Serbia kishte normën më të ulët të rritjes reale të BPV-së (0.5 përqind) (tabela 2). Përderisa në vitin 2014, rritja e ngadalshme e kërkesës së brendshme dhe përkeqësimi i pozicionit të neto eksporteve ndikuan në dobësimin e aktivitetit ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor, ishin pikërisht këta dy faktor që kontribuuan në rikuperimin e aktivitetit të përgjithshëm gjatë vitit 2015. Në kuadër të kërkesës së brendshme, aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2015 vlerësohet të jetë mbështetur si nga rritja e kërkesës, ashtu edhe investimeve, përderisa ishin sektorët e ndërtimit, prodhimit, industrisë, dhe transportit që u karakterizuan me rritje. Për më tepër, rikuperimi i kërkesës së jashtme u përkthye në një rritje të eksporteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Sipas parashikimeve të FMN-së, vendet në Ballkanin Perëndimor pritet të shënojnë një rritje mesatare të BPV-së prej 3.3 përqind në vitin 2016 (2.5 përqind në vitin 2015), ku Mali i Zi pritet të shënojë normën më të lartë të rritjes prej 4.9 përqind, përderisa Serbia pritet të ketë normën më të ulët të rritjes së BPV-së prej 1.5 përqind.


Tabela 2. Rritja reale vjetore e BPV-së në vendet e Ballkanit Perëndimor

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	1.6	1.4	1.9	2.7
Bosnja dhe Hercegovina	-1.2	2.5	1.1	2.1
Kosova	2.8	3.4	1.2	3.0
Maqedonia	-0.5	2.7	3.8	3.2
Mali i Zi	-2.5	3.3	1.5	3.2
Serbia	-1.0	2.6	-1.8	0.5

Burimi: WEO (2016); për Kosovën: ASK dhe vlerësimi i BQK-së për 2015

Ngjashëm me vendet e eurozonës, vendet e Ballkanit Perëndimor janë karakterizuar me shkallë më të ulët të inflacionit në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak, që i atribuohet kryesisht çmimeve të ulëta të naftës, energjisë dhe ushqimit në tregjet ndërkombëtare. Norma mesatare e inflacionit në vendet e rajonit në vitin 2015, sipas FMN-së, vlerësohet të ketë qenë 0.9 përqind (figura 3). Në kuadër të vendeve të rajonit, Shqipëria kishte shkallën më të lartë të inflacionit prej 2.2 përqind në vitin 2015, përderisa vetëm Kosova u karakterizua me deflacion prej 0.5 përqind. Për vitin 2016,

Figura 3. Shkalla mesatare e inflacionit në Ballkanin Perëndimor, në përqindje



Burimi: World Economic Outlook (2016)

për vendet në Ballkanin Perëndimor, FMN ka parashikuar një rritje të normës mesatare të inflacionit në 1.7 përqind.

Gjendja në tregun e punës në vendet e Ballkanit Perëndimor vlerësohet të jetë përmirësuar në vitin 2015 kundrejt vitit paraprak. Sipas FMN-së, shkalla mesatare e papunësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor në vitin 2015 pritet të jetë rreth 24 përqind, me Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kosovën që kanë shkallën më të lartë të papunësisë (43.6 përkatësisht 30 përqind).

Në kuadër të zhvillimeve në sektorin e jashtëm, vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me përqendrim të deficitit të llogarisë rrjedhëse në vitin 2015. Norma mesatare e deficitit të llogarisë rrjedhëse në vendet e rajonit në vitin 2015 pritet të jetë 8.9 përqind e BPV-së, që është për 0.3 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Gjatë vitit 2015, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia raportuan ngushtim të deficitit të llogarisë rrjedhëse, kryesisht si rezultat i zvogëlimit të deficitit në mallra (rritjes më të shpejtë të eksporteve krahasuar me importet) dhe rritjes së fluksit të remitencave. Në anën tjetër, Maqedonia dhe Kosova u karakterizuan me rritje të deficitit në llogarinë rrjedhëse kryesisht si rezultat i rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv në llogarinë e shërbimeve. Ndërkohë, bilanci i Investimeve të Huaja Direkte (IHD), i cili paraqet një komponentë shumë të rëndësishme për financimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, është përmirësuar në vitin 2015. Me përmirësim të bilancit të IHD-ve në vitin 2015 u karakterizuan Shqipëria, Kosova dhe Serbia, përderisa me zvogëlim të vlerës së IHD-ve u karakterizua Maqedonia.

Spektori bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizua me ecure pozitive, e cila u reflektua në përmirësimin e indikatorëve kyç të shëndetit financiar. Vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me nivel të kënaqshëm të kapitalizimit të sektorit bankar. Gjatë vitit të fundit shumica e vendeve në regjion përforcuan nivelin e kapitalizimit, ku mesatarja e kapitalit rregullator ndaj aseteve të peshura me rrezik deri në shtator 2015 ishte rreth 18.7 përqind (18.5 përqind në shtator 2014). Niveli i likuiditetit në sektorin bankar në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor shënoi rënie të lehtë krahasuar me vitin paraprak, duke zvogëluar mesataren e regjionit në 30.2 përqind në shtator 2015 (31.3 përqind në shtator 2014). Në kuadër të performancës së sektorit bankar, vendet në Ballkanin Perëndimor shënuan përmirësim edhe të kualitetit të portfolios kreditore, ku niveli i kredive jo performuese zbriti në 14.5 përqind mesatarisht në nëntë muajt e parë 2015 krahasuar me nivelin prej rreth 15 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu edhe treguesit e profitabilitetit shënuan përmirësim krahasuar me periudhën paraprake, ku ROA e rajonit u përmirësua në 0.8 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015 (0.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014), kurse ROE u përmirësua në mesatarisht 5.9 përqind në nëntë muajt e parë 2015 (4.6 përqind në nëntë muajt e parë 2014).

4. Çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare

4.1. Çmimet e naftës


Çmimet e naftës (brent crude)¹ zbritën në nivelin më të ulët të shënuar në vitet e fundit. Trendi rënës me të cilin u karakterizua niveli i çmimeve të naftës që nga qershori i vitit 2014 vazhdoi edhe në vitin 2015, megjithëse gjatë tremujorit të dytë të këtij viti u evidentua një rikuperim i çmimit mesatar të naftës për barel. Deri në shtator 2015, çmimi mesatar për një barel ishte 55.4 dollar, që tregon për një rënie vjetore të çmimit prej 48.1 përqind (figura 4). Rënia e çmimit të naftës ka vazhduar edhe në muajt e fundit të vitit

2015, duke zbritur në dhjetor 2015 në nivelin më të ulët të shënuar që nga dhjetori i vitit 2003, gjegjësisht në 37.7 dollar për barel. Në vitet e fundit, SHBA-të kanë dyfishuar prodhimin e naftës, gjë që është përkthyer në zvogëlim të importit të naftës nga tregu amerikan. Zvogëlimi i kërkesës për naftë nga SHBA-të, si një importues i madh në periudhat paraprake, ka ndikuar që vendet tjera të zhvilluara dhe vendet në zhvillim të përballen me tepricë të naftës. duke ndikuar në rënie e vazhdueshme të çmimit. Në të njëjtën kohë, ekonomitë e zhvilluara ende po përballen me aktivitet të dobët ekonomik, gjë që ka ndikuar që kërkesa për produktet të naftës të mbetet më e dobët. Për pasojë, mbi oferta e naftës në një periudhë kur kërkesa ishte e ulët si pasojë e një ambienti ende të dobët makroekonomik global, është përkthyer në rënie të çmimeve në tregjet ndërkombëtare veçanërisht gjatë vitit 2015. Gjithashtu, organizata OPEC (angl. Organization of Petroleum Exporting Countries) nuk ka arritur konsensus të brendshëm për zvogëlimin e prodhimit të naftës. Vendet eksportuese të naftës nuk kanë dashur të sakrifikojnë pjesën e tyre të tregut në përpjekje për të rivendosur çmimin në nivele më të larta, gjë që ka mundësuar vazhdimin e rënies së çmimit të këtij produkti.

Parashikimet sugjerojnë se çmimet e naftës pritet të mbesin relativisht të ulëta edhe në vitin 2016, duke mbetur rreth nivelit prej 40 dollar për barel. Çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare pritet të mbesin të ulëta, mbështetur kryesisht nga teprica e ofertës, përderisa kapaciteti për të absorbuar këtë ofertë si nga vendet e zhvilluara, ashtu edhe nga vendet në zhvillim mbetet i kufizuar si pasojë e rritjes modeste ekonomike që vazhdon të karakterizojë ekonominë globale në përgjithësi.

Rënia e çmimeve të naftës gjatë vitit 2015 është përkthyer në rritje të fuqisë blerëse dhe rritje të profitabilitetit të ndërmarrjeve në vendet importuese të naftës, duke ndikuar kështu në rritjen e konsumit privat dhe stimulimin e investimeve. Gjithashtu, çmimet e ulëta të naftës kanë nxitur presione deflacioniste, sidomos te produktet ushqimore, pasi që nafta dhe energjia përbëjnë komponentë mjaft të rëndësishëm në procesin e prodhimit dhe transportimit të tyre. Zvogëlimi i çmimeve të naftës gjatë vitit 2015 vlerësohet të ketë ndikuar pozitivisht edhe në përmirësimin e

Figura 4. Çmimi i naftës 'brent crude', në USD për barel



Burimi: Banka Botërore (2016)

¹ 'Brent Crude' paraqet klasifikim tregtar për naftën e prodhuar në detin e veriut si përfaqësues i nivelit të çmimit të naftës në nivel global.

bilancit të llogarisë rrjedhëse të vendeve importuese të naftës, pasi që për të njëjtën sasi të importuar vlera nominale e pagesave është më e ulët.

4.2. Çmimet e arit


Rënia që karakterizoi përgjithësisht çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare përfshiu edhe çmimet e arit, që deri në shtator 2015 shënuan rënie për mesatarisht 48 përqind (figura 5). Në shtator 2015, një unce ari (31.1 gram ari) ka kushtuar 1178.5 dollarë që është 8.5 përqind më lirë se sa në shtator 2014. Në muajt e fundit të vitit 2015 është vërejtur një rënie e mëtejme e çmimit të arit, ku çmimi për unce ka arritur në 1068.3 dollar apo 11 përqind më lirë se sa në dhjetor të vitit 2015.

Çmimet e arit zakonisht lëvizin në linjë me nivelin e inflacionit, si dhe me dinamikën e aktivitetit ekonomik në tregjet kryesore të vendeve të zhvilluara. Gjatë vitit 2015, presionet inflacioniste kanë qenë përgjithësisht të dobëta, veçanërisht në vendet e zhvilluara, përderisa ekonomia botërore është karakterizuar përgjithësisht me rikuperim ekonomik kundrejt vitit 2014. Përveç nivelit të dobët të inflacionit në vendet e zhvilluara dhe rikuperimit modest të aktivitetit ekonomik, në rënien e çmimit të arit gjatë vitit 2015 mund të ketë ndikuar edhe forcimi i dollarit kundrejt euros, gjë që mund të jetë përkthyer në kërkesë më të vogël për ari.

4.3. Çmimet e metaleve dhe mineraleve


Ngjashëm me mallrat tjera në tregjet ndërkombëtare, edhe çmimet e metaleve dhe mineraleve u karakterizuan me rënie gjatë vitit 2015. Deri në shtator 2015, indeksi i çmimit të metaleve dhe mineraleve ka shënuar rënie mesatare prej 19 përqind (figura 6). Rënia më e madhe e indeksit gjatë vitit 2015 u shënuar në gusht 2015 (29 përqind), ndërkohë që rënia ka vazhduar edhe në muajt e fundit të vitit 2015, ku në dhjetor ky indeks ka shënuar rënie prej 28 përqind. Në kuadër të indeksit të çmimeve të metaleve dhe mineraleve, rënie më të theksuar gjatë vitit 2015 e kanë shënuar metalet e hekurit prej 44 përqind, pasuar nga nikeli dhe plumbi me 26 përkatësisht 14 përqind. Me rënie të çmimit u karakterizuan edhe metalet e mineraleve tjera, si çmimet e bakrit dhe aluminit, që shënuan një rënie vjetore prej 17.6 përkatësisht 6.1 përqind deri në shtator 2015. Efektet nga lëvizjet potenciale në çmimet e

Figura 5. Çmimi i arit, në USD për unce



Burimi: Banka Botërore (2016)

Figura 6. Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve




Burimi: Banka Botërore (2016)

metaleve dhe mineraleve në tregjet ndërkombtare kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e Kosovës, duke qenë se kanë një pjesëmarrje të lartë në gjithsej eksportet dhe importet e Kosovës.

4.4. Çmimet e prodhimeve ushqimore

Çmimet e ushqimit kanë vazhduar trendin e rënies, trend ky i cili filloi që nga viti 2012. Indeksi i çmimeve të ushqimit gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka shënuar rënie për 19 përqind (figura 7). Indeksi i çmimeve të drithërave ka shënuar rënie prej 15 përqind, që mund të shpjegohet nga rënia e çmimeve të naftës gjatë kësaj periudhe dhe vlerësimi i kursit të këmbimit të dollarit amerikan. Çmimet e prodhimeve ushqimore në përgjithësi, dhe në veçanti çmimet e drithërave, u karakterizuan me rënie edhe në pjesën e mbetur të vitit 2015. Në dhjetor të vitit 2015, çmimet e drithërave shënuan një rënie vjetore prej rreth 17 përqind.

Figura 7. Indeksi i çmimeve të ushqimit dhe indeksi i çmimeve të drithërave



Burimi: FAO (2016)

5. Ekonomia e Kosovës


5.1. Bruto Produkti Vendor

Vlerësuar nga ASK, në nëntë muajt e parë të vitit 2015, Bruto Produkti Vendor (BPV) ka arritur vlerën nominale prej 4.25 miliard euro (4.12 miliard euro në nëntë muajt e parë 2014).² Në terma real, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015, BPV vlerësohet të ketë shënuar një normë mesatare të rritjes prej 3.6 përqind. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik në këtë periudhë ishte kryesisht rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, gjegjësisht konsumit dhe investimeve. Gjatë kësaj periudhe, neto eksportet ndikuan negativisht në normën e rritjes ekonomike.

Sipas statistikave të publikuara nga ASK, në tremujorin e parë të vitit 2015, BPV shënoi një rritje vjetore prej 1.7 përqind, kundrejt rritjes prej 0.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në tremujorin e dytë 2015, ekonomia e Kosovës u karakterizua me një rritje më të shpejtë vjetore prej 4.8 përqind (rënie vjetore prej 1.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014), përderisa në tremujorin e tretë 2015 rritja reale e BPV-së ishte 4.0 përqind (2.9 përqind në tremujorin e njëjtë të vitit 2014).

Vlerësimet fillestare të BQK-së për tërë vitin 2015 sugjeruan se vlera nominale e BPV-së kishte arritur në 5.76 miliard euro, që paraqet një normë reale të rritjes prej 3.5 përqind (1.2 përqind në vitin 2014) (figura 8). Megjithatë, duke pasur parasysh zhvillimet në ekonominë e vendit gjatë tremujorit të katërt të vitit 2015, vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se norma reale e rritjes së BPV-së në vitin 2015 ka qenë 3.0 përqind. Në tremujorin e katërt të vitit 2015 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit 2014, rrjedha e transferave të pranuar në vend nga sektori i jashtëm u karakterizua me rënie. Shuma e remitencave të pranuar në Kosovë dhe të hyrat nga kompenzimi i punëtorëve ishin për 2.4 përkatësisht 3.4 përqind më të ulëta në të tremujorin e katërt të vitit 2015 kundrejt tremujorit të katërt të vitit paraprak. Poashtu, shumta e kredive të reja konsumuese të lëshuara gjatë këtij tremujori ishte për 19.5 përqind më e ulët krahasuar me shumën e kredive të reja konsumuese të lëshuara në tremujorin e katërt të vitit 2014. Tremujori i katërt i vitit 2015 ishte më pak i favorshëm krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak edhe për sa i përket tregtisë së jashtme. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve gjatë tremujorit të katërt të vitit 2015 shënoi rënie vjetore prej 9.0 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie vjetore prej 0.8 përqind. Rrjedhimisht, deficitin në neto eksporte shënoi rritje prej 3.9 përqind në tremujorin e katërt të vitit 2015, duke ndikuar negativisht rritjen reale të ekonomisë së vendit.

Figura 8. Norma reale e rritjes së BPV-së



* Vlerësim i BQK-së
Burim: ASK (2016)

² BPV-ja për nëntë muajt e parë të vitit 2015 është kalkuluar duke agreguar shumata e BPV-së së vlerësuar nga ASK-ja për tremujorin e parë, të dytë dhe të tretë të vitit 2015.

5.1.1 Qasja e shpenzimeve

Dinamika e aktivitetit ekonomik në vend në nëntë muajt e parë të vitit 2015 vlerësohet të jetë përshpejtuar kundrejt vitit paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së konsumit të përgjithshëm dhe investimeve për 1.5 përkatësisht 9.2 përqind. Në këtë periudhë, komponenta e konsumit kontribuoi në rritjen vjetore të BPV-së reale me rreth 1.7 pikë përqindje, përderisa investimet kontribuan me 2.5 pikë përqindje. Komponenta e neto eksporteve kontribuoi negativisht në rritjen vjetore ekonomike me 0.4 pikë përqindje në nëntë muajt e parë të vitit 2015.


Struktura e BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve dominohet nga konsumi, që në nëntë muajt e parë 2015 kishte një pjesëmarrje prej 101.8 përqind në gjithsej BPV-në (104.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2014). Në anën tjetër, pjesëmarrja e investimeve në BPV arriti në 27.5 përqind (26.0 përqind në nëntë muajt e parë 2014). Komponenta e neto eksporteve vazhdon të ketë pjesëmarrje negative në BPV me normë prej -29.3 përqind (-30.2 përqind në nëntë muajt e parë 2014) (figura 9).

Në kuadër të konsumit të përgjithshëm, konsumi privat shënoi rritje vjetore prej 2.6 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Rritja e konsumit privat gjatë kësaj periudhe është mbështetur nga rritja e kreditimit bankar si dhe nga flukset më të mëdha hyrëse të transfereve nga jashtë në formë të remitencave dhe kompenzimit të punëtorëve. Gjithashtu, rritja e pagave dhe pensioneve të sektorit publik në vend kishte efekt të plotë në vitin 2015, duke ndikuar kështu në rritjen e mëtejme të të ardhurave të disponueshme në ekonomi. Në anën tjetër, përkundër rritjes nominale prej 4.2 përqind të konsumit publik në nëntë muajt e parë 2015, sipas ASK-së, në terma real kjo komponentë shënoi rënie vjetore prej 4.5 përqind në periudhën raportuese. Rënia reale e konsumit publik ishte kryesisht pasojë e efektit të deflatimit që kishte rritja e pagave për punonjësit e sektorit publik.

Në kuadër të BPV-së, pozicioni i përgjithshëm i investimeve u karakterizua me rritje vjetore prej 9.2 përqind, mbështetur kryesisht në rritjen e investimeve të sektorit privat. Rritja e IHD-ve dhe kredive të reja investuese gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015 ndikuan në përf forcimin e pozicionit të investimeve private. Gjatë kësaj periudhe, investimet publike shënuan rënie.

Efkti i rritjes së eksporteve të mallrave dhe shërbimeve kosovare u mënjanua nga rritja më e shpejtë e importit, duke rezultuar kështu në zgjerimin e deficitit të pozicionit të neto eksporteve për 1.3 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015.

Figura 9. Struktura e komponentëve të BPV-së sipas qasjes së shpenzimeve, në përqindje



Burimi: ASK (2016)

5.1.2 Qasja e prodhimit

Struktura e BPV-së në Kosovë dominohet nga sektorët e shërbimeve³, që kanë një pjesëmarrje prej afërsisht 50 përqind në strukturën e përgjithshme të BPV-së. Në kuadër të gjithsej BPV-së, administrimi publik ka një pjesëmarrje prej 13.4 përqind, pasuar nga sektori i tregtisë dhe bujqësisë, që kanë pjesëmarrje prej 12.2 përkatësisht 11.3 përqind në gjithsej BPV-në. Pjesëmarrje të konsiderueshme kanë edhe sektori i industrisë përpunuese (9.7 përqind) dhe afarizmi me pasuri të patundshme (8.8 përqind) (figura 10).

Për dallim nga nëntë muajt e parë të vitit 2014, kur rritja ekonomike ishte mbështetur kryesisht nga rritja e aktivitetit në sektorin e tregtisë, sektorin financiar dhe të sigurimit, si dhe në shërbime tjera, në nëntë muajt e parë të vitit 2015 rritja ekonomike ishte kryesisht rezultat i rritjes së aktivitetit në sektorin e ndërtimitarisë, bujqësisë dhe furnizimit me energji elektrike.


Sektori i ndërtimitarisë kontribuoi me 0.9 pikë përqindje në rritjen vjetore të BPV-së reale në nëntë muajt e parë të vitit 2015, pasuar nga furnizimi me energji elektrike (0.6 pikë përqindje). Rritja e vlerës së shtuar të aktivitetit ekonomik në sektorin e bujqësisë ndikoi që ky sektor të kontribuojë në rritjen e përgjithshme të BPV-së me 0.5 pikë përqindje. Gjithashtu, ecuri të mirë shfaqti edhe sektori i tregtisë, që kontribuoi me 0.5 pikë përqindje. Rritja e BPV-së në vend është mbështetur edhe nga rritja në shërbimet e transportit dhe hotelet e restorantet, që kontribuan me 0.2 pikë përqindje. Në anën tjetër, ndikim negativ në rritjen vjetore të BPV-së deri në shtator 2015 kishin sektorët e administrimit publik dhe shërbimeve tjera që kontribuan me -0.7 përkatësisht -0.1 pikë përqindje.

Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, me rritje më të shpejtë të vlerës së shtuar të aktivitetit u karakterizuan sektori i furnizimit me energji elektrike (16.1 përqind), pasuar nga sektori i ndërtimitarisë (13.6 përqind), sektori i transportit (5.8 përqind) dhe sektori i bujqësisë (4.0 përqind). Gjatë kësaj periudhe, me rënie vjetore u karakterizua vlera e shtuar në aktivitetin e administrimit publik (5.0 përqind), sektorit të shërbimeve tjera (1.2 përqind) dhe vlera e shtuar në aktivitetin e shërbimeve financiare dhe të sigurimit (0.9 përqind).

Sa i përket zhvillimeve tremujore në aktivitetin ekonomik në vend, në tremujorin e parë të vitit 2015, rritja ekonomike vlerësohet të jetë mbështetur kryesisht nga aktiviteti në sektorin e bujqësisë, që shënoi një rritje vjetore prej 3.5 përqind. Gjithashtu, gjatë tremujorit të parë 2015, me rritje u karakterizuan edhe sektorët si tregtia (3.9 përqind), transporti (9.0 përqind) dhe aktivitetet financiare (4.6 përqind).

Aktiviteti ekonomik në tremujorin e dytë rezultoi të jetë mbështetur nga përmirësimi i mëtejshëm i aktivitetit në sektorin e bujqësisë, që shënoi një rritje vjetore prej 6.1 përqind, pasuar nga sektori i tregtisë dhe transportit që shënuan një rritje vjetore prej 6.9 përkatësisht 5.3 përqind.

Figura 10. Komponentët e BPV-së, sipas aktivitetit ekonomik, në miliard euro



Burimi: ASK (2016)

³ Bazuar në publikimin e ASK-së, sektorët e shërbimeve përfshijnë: furnizimi me energji elektrike, gaz, ujë; tregtia me shumicë dhe pakicë; transporti; hotelet dhe restorantet; aktivitetet financiare dhe të sigurimit; afarizmi me pasuri të patundshme; administrimi publik; shërbime të tjera.

Në këtë tremujor, me rënie prej 7.5 përqind u karakterizua sektori i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit. Përderisa aktiviteti në sistemin financiar në nëntë muajt e parë 2015 është karakterizuar me rritje, vlera e shtuar në aktivitetet financiare dhe të sigurimit vlerësohet të ketë shënuar rënie kryesisht si pasojë e zvogëlimit të kostos së ndërmjetësimit financiar gjatë kësaj periudhe.


Gjatë tremujorit të tretë, me performancë të mirë u karakterizuan sektorët si bujqësia, industria përpunuese, ndërtimtaria dhe tregtia. Në këtë periudhë, vlera e shtuar në aktivitetin bujqësor u karakterizua me një rritje vjetore prej 2.1 përqind, pasuar nga sektori i ndërtimtarisë (25.8 përqind), industrisë përpunuese (1.3 përqind) dhe tregtisë (2.5 përqind). Në anën tjetër, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2015, vlera e shtuar në aktivitetin e sektorit të administrimit publik dhe vlera e shtuar në aktivitetin e shërbimeve tjera shënuan rënie prej 7.3 përkatësisht 0.3 përqind.

5.2. Çmimet

Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, e sidomos me lëvizjet e çmimeve në vendet e eurozonës me të cilat Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare. Sikurse çmimet në tregjet globale, të cilat janë karakterizuar me rënie të theksuar, edhe çmimet në Kosovë janë karakterizuar me rënie deri në shtator 2015. Norma mesatare vjetore e deflacionit, shprehur përmes indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), deri në shtator 2015 ishte 0.6 përqind, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak ishte shënuar inflacion prej 0.5 përqind.


Në rënien e çmimeve kontributin⁴ kryesor e kishin kategoria e transportit e cila ndikoi negativisht me 1.7 pikë përqindje, pastaj kategoria e orendive dhe veshmbathjes të cilat ndikuan negativisht me nga 1.2 pikë përqindje secila, shëndetësia dhe arsimit të cilat kontribuan negativisht me nga 0.4 përkatësisht 0.2 pikë përqindje. Në anën tjetër, ushqimi dhe pijet jo-alkoolike kanë kontribuar pozitivisht me 3.2 pikë përqindje, si dhe energjia me 1.7 pikë përqindje (figura 11).

Figura 11. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij, ndryshimi vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

Figura 12. Çmimet e shërbimeve, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

⁴ Kalkulimi i kontributit të komponentëve të IÇK-së në nivelin e inflacionit, përveç lëvizjes së çmimeve, bazohet edhe në peshën që kanë komponentët e caktuar në IÇK. Mund të ndodhë që ndonjë kategori e caktuar të ketë shënuar rritje të çmimeve por në të njëjtën kohë zvogëlim të peshës në gjithsej IÇK-në. Në këtë rast, nëse zvogëlimi i peshës është më i lartë se sa rritja e çmimit atëherë kontributi është negativ në gjithsej IÇK-në.


Mesatarja vjetore e çmimeve të shërbimeve deri në shtator 2015 shënoi rënie për 6.6 përqind. Pothuajse të gjitha kategoritë e shërbimeve shënuan rënie të çmimeve. Rënien më të madhe të çmimeve e shënuan shërbimet arsimore për 28.0 përqind, pasuar nga çmimet e shërbimeve të transportit të cilat shënuan rënie për 7.6 përqind. Rënia e çmimit të shërbimeve arsimore i atribuohet vendimit të qeverisë për zbritjen e pagesës për 50 përqind për studentët e universiteteve publike, vendim i cili është aplikuar me fillimin e vitit akademik në tetor të vitit 2014, ndërsa rënia e çmimeve të shërbimeve të transportit i atribuohet rënies së çmimit të derivateve të naftës. Përveç çmimeve të transportit dhe arsimit, me rënie u karakterizuan edhe çmimet e shërbimeve në restorante dhe hotele (rënie prej 3.2 përqind), rekreacion dhe kulturë (rënie prej 0.9 përqind) si dhe shërbimet e komunikimit të cilat shënuan rënie prej 0.3 përqind (figura 12).

Kategoria e pijeve alkoolike dhe duhanit shënoi rritje të çmimeve për 5.1 përqind. Në kuadër të kësaj kategorie, çmimet e duhanit shënuan rritje për 5.0 përqind, ndërsa çmimet e pijeve alkoolike shënuan rritje për 5.5 përqind. Siç është paraqitur në figurën 13, lëvizjet në çmimet e duhanit në Kosovë përcaktohen në masë të konsiderueshme nga akciza e aplikuar për këtë produkt.

Me rritje janë karakterizuar edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike të cilat shënuan rritje për 0.6 përqind, përderisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak kishin shënuar rënie për 0.6 përqind. Në kuadër të kategorisë së ushqimit, rritje më të theksuar shënuan çmimet e pemëve prej 7.5 përqind, pasuar nga çmimet e perimeve prej 4.9 përqind, pastaj buka dhe drithërat 1.4 përqind, si dhe vajrat dhe yndyrat 1.1 përqind, ndërsa qumështi, djathi dhe vezët shënuan rënie të çmimeve prej 2.7 përqind (figura 14).


Çmimet e strehimit, ujit, rrymës dhe lëndëve tjera djegëse deri në shtator 2015 shënuan rritje mesatare prej 1.6 përqind (rritje prej 3.9 përqind deri në shtator 2014). Kjo rritje e çmimeve të

Figura 13. Indeksi i çmimeve të duhanit dhe akciza në duhan në euro




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

Figura 14. Çmimet e ushqimit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

Figura 15. Çmimet e strehimit, ujit dhe energjisë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulime të BQK-së (2016)

kësaj kategorie ishte për shkak të rritjes së çmimeve të rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse për 5.9 përqind si dhe rritjes së çmimit të furnizimit me ujë dhe çmimeve për shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin për 0.4 përqind, ndërkohë që çmimet e pagesave për banim mbetën të pandryshuara krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2014 (figura 15).


Lëvizja e çmimeve të nënkategorisë së rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse është në masë të konsiderueshme e përcaktuar nga lëvizja e çmimit të energjisë që kanë peshën më të madhe në kuadër të kësaj nënkategorie. Siç edhe është paraqitur në figurën 16, indeksi i çmimit të energjisë, i cili karakterizohet me ndryshime të theksuara sezonale (varësisht nga tarifa verore dhe dimërore), është karakterizuar me trend rritës.

Sa i përket normës reale efektive të këmbimit (NREK) të euros në Kosovë kundrejt valutave të partnerëve tregtarë, e cila bazohet në çmimet e konsumit, deri në shtator 2015 ajo u zhvlerësua për mesatarisht 2.0 përqind. Ky zhvlerësim NREK-ut ishte rezultat i inflacionit, i cili ishte më i ulët në Kosovë krahasuar me partnerët tregtarë, por edhe për shkak të zhvlerësimit të euros krahasuar me shumicën e valutave të partnerëve tregtarë. NREK u zhvlerësua për 0.5 përqind ndaj vendeve të CEFTA-s, e po ashtu për 0.5 përqind ndaj vendeve të BE-së, gjë që nënkupton se produktet kosovare mund të kenë rritur konkurrueshmërinë ndaj këtyre vendeve.

5.2.1. Inflacioni bazë


Shporta e konsumatorit kosovar karakterizohet me pjesëmarrje mjaft të lartë të produkteve të cilat kanë lëvizje sezonale të çmimeve. Këtu përfshihen ushqimi, energjia, pijet alkoolike dhe duhani të cilat përbëjnë rreth gjysmën e shportës së konsumatorit. Çmimet e këtyre produkteve kanë determinuar lëvizjen e indeksit të përgjithshëm të çmimeve gjatë viteve të kaluara jo vetëm për shkak të pjesëmarrjes së lartë që e kanë në shportën e konsumatorit por edhe për shkak se lëvizja e këtyre çmimeve ka qenë më e theksuar (tabela 3). Kjo bënë që ndikimi i këtyre kategorive në lëvizjen e indeksit të përgjithshëm të çmimeve të jetë më i lartë se sa në vendet tjera të cilat kanë pjesëmarrje më të ulët të këtyre kategorive në shportën e konsumatorit. Sidoqoftë, në vitet e fundit vërehet një stabilitet i çmimeve të këtyre produkteve por edhe tendencë rënëse në nivelin e pjesëmarrjes në gjithsej shportën e konsumatorit.

Figura 16. Indeksi i çmimit të energjisë dhe çmimi për KWh



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

Figura 17. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, rritja vjetore në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

Inflacioni bazë, i cili përjashton kategoritë të cilat karakterizohen me ndryshim më të theksuar të çmimeve, paraqet një pasqyrë më të qartë lidhur me inflacionin në Kosovë (figura 17). Më specifikiisht, inflacioni bazë i cili përjashton çmimet e ushqimit dhe të energjisë, deri në shtator 2015 kishte normë prej 0.6 përqind. Inflacioni bazë historikisht ka qenë më stabil se sa inflacioni i përgjithshëm, ndërsa në dy vitet e fundit, për shkak të rënies së çmimeve të ushqimit, dallimi ndërmjet inflacionit bazë dhe inflacionit të përgjithshëm është më i vogël (tabela 3).

Tabela 3. Struktura e IÇK-së


Përshkrimi	Peshat 2014	Mesatarja vjetore e rritjes, %			
		Shtator 2012	Shtator 2013	Shtator 2014	Shtator 2015
IÇK	100.0%	2.1	2.2	0.5	-0.6
<i>Struktura e IÇK-së:</i>					
Ushqimi	38.2%	-0.4	3.2	-0.6	0.6
Energjia	7.6%	8.8	0.6	3.2	3.6
Mallrat tjerë	21.6%	4.5	4.3	3.3	3.1
Shërbimet	32.7%	1.6	1.4	0.6	-5.5
<i>Inflacioni bazë, përjashtuar:</i>					
Ushqimin	61.9%	2.2	0.9	0.8	-0.8
Ushqimin dhe energjinë	54.3%	1.6	0.8	0.5	-1.1

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

5.2.2. Çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme dhe të pa tregtueshme⁵


Me qenë se ekonomia e Kosovës është ekonomi e vogël dhe e varur nga importi, është e natyrshme që komponentët e tregtueshëm të mallrave dhe shërbimeve të kenë një pjesëmarrje të lartë në IÇK dhe, rrjedhimisht, të përcaktojnë lëvizjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Komponentët e tregtueshëm përbëjnë rreth 81.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar, ndërsa komponentët e pa tregtueshëm (kryesisht shërbimet) përbëjnë rreth 18.1 përqind të shportës së konsumatorit (figura 18). Çmimet e mallrave dhe shërbimeve të patregtueshme historikisht kanë qenë më stabile krahasuar me çmimet e mallrave të tregtueshme, me përjashtim të dy viteve të fundit ku rënia e çmimeve të mallrave të patregtueshme ishte më e theksuar

Figura 18. Pjesmarrja e komponentëve të tregtueshëm dhe të patregtueshëm në IÇK



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

Figura 19. Indekset e komponentëve të tregtueshëm dhe të patregtueshëm



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

⁵ Komponentët e tregtueshëm konsiderohen mallrat dhe shërbimet të cilat tregtohen edhe në tregjet ndërkombëtare, ndërsa ato të patregtueshëm janë ato të cilat konsumohen vetëm brenda vendit. Rrjedhimisht, edhe faktorët që ndikojnë në çmime dallojnë te komponentët e tregtueshëm dhe ata të patregtueshëm. Komponentët e patregtueshëm ndikohen nga faktorë të tillë si kërkesa dhe oferta vendore, ndërsa komponentët e tregtueshëm përveç kërkesës dhe ofertës vendore ndikohen edhe nga çmimet ndërkombëtare të cilat përcaktohen nga kërkesa dhe oferta ndërkombëtare.

(figura 19). Deri në shtator 2015, çmimet e mallrave dhe shërbimeve të patregtueshme shënuan rënie për 2.9 përqind, ndërsa çmimet e mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme shënuan rënie për 0.4 përqind. Rënia e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të tregtueshme është kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të importit, ndërsa rënia e çmimeve të mallrave të patregtueshme më tepër i atribuohet aktivitetit ekonomik në vend. Vendimi i qeverisë për uljen e tarifave për studentët e universiteteve publike si dhe rënia e çmimeve të importit në mënyrë indirekte, përmes lëndëve të para të importuara, mund të kenë ndikuar në rënien e çmimeve të mallrave të patregtueshme.

5.2.3. Çmimet e importit dhe çmimet e prodhimit

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë janë mjaft të ngjashme me lëvizjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe. Kjo konfirmohet edhe nga sjellja e ngjashme e indeksit të çmimeve të importit me indeksin e çmimeve të konsumit (figura 20). Mesatarja e indeksit të çmimeve të importit deri në shtator 2015 ka shënuar rënie për 0.6 përqind, ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur ishte shënuar rënie prej 0.6 përqind. Çmimet e produkteve minerale (kryesisht naftës dhe derivateve të saj) të cilat janë kategoria kryesore e indeksit të çmimeve të importit (rreth 20 përqind e gjithëj indeksit) shënuan rënien më të lartë prej 14.5 përqind krahasuar me rënien prej 5.9 përqind të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, çmimet e plastikës, kauçikut dhe artikujve prej tyre shënuan rënie prej 5.7 përqind, pasuar nga metalet bazë me rënie prej 3.9 përqind, si dhe mjetet e transportit me rënie prej 2.1 përqind. Në anën tjetër, çmimet e produkteve bimore dhe pajisjet e makinerisë shënuan rritjen më të lartë me 26.5 përkatësisht 8.3 përqind.

Çmimet e prodhimit, deri në shtator 2015, shënuan rritje për 3.5 përqind (0.8


përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit 2014). Rritje e çmimeve të prodhimit më së shumti është evidentuar te çmimet e prodhimit të produkteve kimike të cilat shënuan rritje për 17.0 përqind. Rritja e çmimeve të prodhimit u evidentua edhe te energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar për 10.0 përqind, druri dhe produktet e drurit për 8.8 përqind, etj. Në anën tjetër, disa kategori të prodhimit shënuan rënie të çmimeve. Rënie më e rëndësishme e çmimeve u regjistrua te kategoritë e prodhimit si në vijim: produktet metalike 7.2 përqind, lëkura dhe produktet prej lëkurës 5.4 përqind, letra dhe produktet e letrës 5.2 përqind, si dhe përpunimi i produkteve ushqimore 4.1 përqind.

5.3. Zhvillimet Sektoriale

Energjetika

Sektori i energjisë gjatë vitit 2015 është karakterizuar me një performancë më të mirë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, prodhimi i thëngjillit, gjegjësisht sasia e thëngjillit që është nxjerrë nga minierat ka shënuar rritje. Sasia e

Figura 20. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2016)

thëngjillit që nxirret nga minierat, dhe që përbën lëndën bazë djegëse për prodhim të energjisë elektrike në vend, është karakterizuar me një rritje prej rreth 15 përqind. Në të njëjtën periudhë, prodhimi bruto i energjisë elektrike në termocentrale dhe prodhimi i energjisë në hidrocentrale është karakterizuar me rritje. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, me një rritje prej rreth 7 përqind është karakterizuar energjia e prodhuar në termocentrale, përderisa energjia e prodhuar në hidrocentrale ka shënuar rritje prej rreth 16 përqind. Rritja e prodhimit të energjisë tregon për rikuperimin e sektorit të energjisë në tremujorin e dytë dhe sidomos tremujorin e tretë të vitit 2015, pas rënies që pësoi në vitin paraprak si pasojë e shpërthimit që ndodhi në qershor të vitit 2014 në Termocentralin Kosova A (figura 21).


Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015, sipas ASK-së, konsumi i energjisë, ka shënuar një rritje vjetore prej rreth 6.4 përqind. Rritja e konsumit të energjisë elektrike deri në shtator 2015 është mbuluar kryesisht nga rritja e energjisë së prodhuar në këtë periudhë, përderisa

importi i energjisë elektrike u karakterizua me një rënie prej rreth 9.8 përqind. Në të njëjtën kohë, eksporti i energjisë elektrike u karakterizua me rënie prej 3.7 përqind. Me rritje të konsumit u karakterizuan pothuajse të gjithë konsumatorët final, gjegjësisht amvisëria, konsumatorët (220-110 kV) dhe industria. Në të njëjtën periudhë, ndërmarrjet publike rezultuan të kenë konsumuar më pak energji kundrejt vitit paraprak (figura 22).

Si pasojë e rënies më të madhe të importit kundrejt rënies së eksportit të energjisë elektrike, në nëntë muajt e parë të vitit 2015, Kosova ka realizuar bilanc negativ tregtar të energjisë me sektorin e jashtëm prej 163.7 GWh (209.4 GWh deri në shtator 2014). Eksporti i energjisë kishte zbritur në vlerën prej 391.2 GWh deri në shtator 2015 (406.1 GWh në nëntë muajt e parë 2014), ndërsa importi kishte zbritur në vlerën prej 554.9 GWh (615.5 GWh në nëntë muajt e parë 2014).


Niveli i humbjeve në rrjet në sektorin e energjisë vazhdon të mbetet relativisht i lartë. Krahasuar me vitin paraprak, humbjet në rrjet në sektorin e energjisë kanë shënuar rritje prej 0.5 përqind. Për kundër rritjes, energjia e humbur në rrjet përfaqësoi rreth 37 përqind të gjithë prodhimit të energjisë deri në shtator 2015, që paraqet një normë më të ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur energjia e humbur në rrjet përfaqësoi 39 përqind të gjithë energjisë së prodhuar. Zvogëlimi i këtij raporti kryesisht i atribuohet rritjes së prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike gjatë kësaj periudhe.

Figura 21. Prodhimi, konsumi dhe bilanci i energjisë (Giga watt për orë)



Burimi: ASK (2016)

Figura 22. Konsumi i energjisë sipas përdoruesit të fundit



Burimi: ASK (2016)

Transporti⁶


Transporti hekurudhor në Kosovë u karakterizua me rënie në nëntë muajt e parë të vitit 2015, si në kuadër të udhëtarëve që shfrytëzuan hekurudhat në vend, ashtu edhe në kuadër të mallrave të transportuara përmes hekurudhave. Deri në shtator 2015, numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar transportin hekurudhor ishte 204 mijë veta apo 20.6 përqind më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në anën tjetër, sasia e mallrave të transportuara përmes hekurudhave të Kosovës deri në shtator 2015 ishte 578 mijë tonë apo 17.8 përqind më pakë se sa në vitin paraprak (figura 23).

Për dallim nga transporti hekurudhor, transporti ajror në nëntë muajt e parë të vitit 2015 është karakterizuar me rritje të numrit të udhëtarëve dhe numrit të fluturimeve. Numri i përgjithshëm i udhëtarëve që udhëtuan përmes transportit ajror deri në shtator ishte 4,947 veta, që tregon për një rritje prej 7.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa numri prej 1,216 fluturimeve të realizuara deri në shtator 2015 paraqet një rritje vjetore prej 11.9 përqind (figura 24). Industria

Cikli i zhvillimit në sektorin e industrisë në Kosovë, prezantuar në formë të indeksit të qarkullimit të përgjithshëm industrial, përfaqësohet nga aktiviteti në industrinë nxjerrëse, industrinë përpunuese, furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar dhe furnizim me ujë dhe trajtim të mbeturinave.


Deri në shtator 2015, prodhimi industrial në vend rezulton të ketë shënuar rënie të qarkullimit në sektorin e industrisë nxjerrëse prej mesatarisht 22 përqind. Në të njëjtën periudhë, rënie e qarkullimit u shënuar edhe në furnizimin me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar si dhe furnizimin me ujë, veprimtari

Figura 23. Transporti hekurudhor në Kosovë




Burimi: ASK (2016)

Figura 24. Transporti ajror në Kosovë



Burimi: ASK (2016)

Figura 25. Indeksi i qarkullimit industrial



Burimi: ASK (2016)

⁶ Në publikimin e ASK-së për statistikën e transportit, përveç transportit hekurudhor dhe atij ajror, nuk ekzistojnë të dhëna lidhur me transportin rrugor.

të menaxhimit dhe trajtim të mbeturinave (mesatarisht për 3 përkatësisht 10 përqind) (figura 25). Në anën tjetër, prodhimi industrial rezulton të ketë shënuar rritje të qarkullimit në sektorin e industrisë përpunuese (rreth 11 përqind mesatarisht deri në shtator 2015).

Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, me rritje u karakterizuan sektorët që për aktivitet kanë përpunimin e plastikës dhe produkteve të plastikës, përpunimin dhe procesimin e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, si dhe përpunimin e letrës dhe artikujve të letrës. Në anën tjetër, zvogëlimi i aktivitetit në industrinë nxjerrëse, që kryesisht dominohet nga sektori mineral, mund t'i atribuohet deri në një masë rënies vjetore të metaleve kryesore që Kosova eksporton (veçanërisht plumbit dhe nikelit) në nëntë muajt e parë të vitit 2015 në tregjet ndërkombëtare.


5.3.1. Sektori i ndërmarrjeve

Zhvillimet në kuadër të regjistrit të bizneseve private në nëntë muajt e parë të vitit 2015 u karakterizuan me rritje të numrit të ndërmarrjeve të reja dhe po ashtu rritje të numrit të ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i gjithsej ndërmarrjeve të reja deri në shtator 2015 ishte 7,353 krahasuar me 7,230 sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Numri i bizneseve të mbyllura në deri në shtator 2015 arriti në 1,235 krahasuar me 1,224 biznese të mbyllura sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit 2014 (figura 26). Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, raporti ndërmjet ndërmarrjeve të mbyllura dhe ndërmarrjeve të reja ishte 16.7 përqind (17.1 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Sa i përket strukturës së ndërmarrjeve të reja, trendi ka vazhduar të jetë relativisht i ngjashëm me vitet paraprake. Ndërmarrjet tregtare vazhdojnë të dominojnë strukturën e ndërmarrjeve të reja dhe përfaqësojnë 29 përqind të gjithsej ndërmarrjeve të reja të regjistruara. Sidoqoftë, vërehet një rritje e ndërmarrjeve bujqësore nga 7.0 përqind deri në shtator 2014 në 9.2 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2015.


Gjithashtu, ndërmarrjet prodhuese rritën pjesëmarrjen nga 10.5 përqind sa ishte deri në shtator 2014 në 10.6 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Rritja e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara në sektorin e bujqësisë dhe prodhimit deri në një shkallë mund të reflektojë edhe përshpejtimin e rritjes së kreditimit bankar për këta sektorë të ekonomisë. Me zvogëlim të pjesëmarrjes në gjithsej ndërmarrjet e reja të regjistruara u karakterizuan ndërmarrjet që për aktivitet kanë tregtinë, hotelerinë, ndërtimtarinë, transportin, etj. (figura 27).

Figura 26. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2016)

Figura 27. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2016)

Sa i përket madhësisë së ndërmarrjeve, pjesëmarrjen më të lartë (rreth 99 përqind) në gjithsej ndërmarrjet e regjistruara deri në shtator 2015 e kishin kategoria e mikro ndërmarrjeve (1 – 9 të punësuar). Pjesëmarrje shumë më të ulët kanë ndërmarrjet e vogla me 10 – 49 të punësuar (0.9 përqind në shtator 2015), përderisa vetëm 0.1 përqind e gjithsej ndërmarrjeve të regjistruara (8 ndërmarrje) janë ndërmarrje të regjistruara si ndërmarrje të mesme dhe të mëdha.

Tregu i punës⁷


Në vitin 2014, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në Kosovë ishte 41.6 përqind, një shkallë e ulët krahasuar me mesataren e vendeve të rajonit (rreth 50 përqind) (figura 28). Shkalla e ulët e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vend mund t'i atribuohet deri në një masë popullsisë relativisht të re, kategori që klasifikohet si joaktive. Sipas ASK-së, mundësia që popullata joaktive të rritet në mënyrë të vazhdueshme mbetet e lartë, përderisa çdo vit rreth 36,000 të rinj i shtohen popullsisë në moshë pune, ndërkohë që vetëm rreth 10,000 largohen nga popullsia në moshë pune.

Bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore për vitin 2014, norma e punësimit në vitin 2014 qëndroi në 26.9 përqind (figura 29). Punësimi është kryesisht i koncentruar në sektorët e shërbimeve dhe sektorin e prodhimit, sektor që bashkërisht punësojnë mbi 90 përqind të gjithsej të punësuarve në treg. Në mesin e sektorëve të shërbimeve, sektori i tregtisë punëson rreth 14 përqind të gjithsej të punësuarve, pasuar nga sektori i arsimit me rreth 12 përqind. Gjithashtu, janë sektori i ndërtimitarisë që punëson rreth 11 përqind të gjithsej punonjësve në treg, pasuar nga aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale me rreth 7 përqind. Te dhënat në tre vitet e fundit tregojnë se punësimi në sektorët e shërbimeve ka shënuar rritje, përderisa sektorët si bujqësia, dhe minierat kanë shënuar rënie.

Sipas grup-moshave, popullsia e moshës mes 45-54 vjeç ka normën më të lartë të punësimit (38.1 përqind të gjithsej numrit të punësuarve), përderisa grup-mosha 15-24 vjeç ka normën më të ulët të punësimit (9 përqind).


Rreth 25 përqind e personave të punësuar në vitin 2014 deklaruan të punojnë në vende pune të paqëndrueshme.⁸ Të punësuarit që kishin deklaruar të jenë të angazhuar në punë të paqëndrueshme ishin individë të vetëpunësuar, ose individë që punojnë pa pagesë në një biznes

Figura 28. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore



Burimi: ASK (2016)

Figura 29. Shkalla e punësimit



Burimi: ASK (2016)


⁷ Seksioni "Tregu i punës" bazohet në të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore për vitin 2014, publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

⁸ Sipas ASK-së, si persona të punësuar në vende pune të paqëndrueshme janë deklaruar personat pa punonjës dhe ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar.

familjar. Këto dy grupe të punësuarish kanë gjasat më të vogla të kenë një marrëveshje formale pune.

Sipas rezultateve të anketës, shkalla e punësimit të gjinia femërore ka mbetur në një përqindje të pandryshueshme nga viti paraprak prej rreth 13 përqind, me shkallë më të lartë të punësimit të koncentruar te moshë 25 deri 44 vjeç. Te gjinia mashkullore, shkalla e punësimit në vitin 2014 ka qenë 41 përqind, përderisa shkalla e punësimit ishte më e larta për grup moshën 35-44 vjeç. Sipas nivelit arsimor, rreth 40 përqind e të punësuarve kishin të përfunduar arsimin e mesëm profesional, kurse rreth 26

Figura 30. Shkalla e papunësisë



Burimi: ASK (2016)

përqind kishin të përfunduar arsimin terciar. Sipas anketës, punëtorët që kishin të përfunduar arsimin e mesëm profesional ishin kryesisht të punësuar në sektorin privat (kompani private, individuale private, etj), përderisa punëtorët që kishin të përfunduar arsimin terciar ishin të punësuar në sektorin publik dhe sektorin privat (kryesisht ndërmarrje në pronësi).

Statistikat e tregut të punës në Kosovë tregojnë për një shkallë të papunësisë prej 35.3 përqind në vitin 2014 (figura 30). Krahasuar me vitin 2013, shkalla e papunësisë rezulton të ketë shënuar rritje, veçanërisht tek të rinjtë (grup-moshë 15-24 vjeç). Në vitin 2014, të rinjtë kishin dy herë më shumë gjasa të jenë të papunë krahasuar me të rriturit, përderisa rreth 61 përqind e popullsisë së re ishte e papunë. Përqindja e të rinjve (15-24 vjeç) të papunë në papunësinë e përgjithshme ishte 28.5 përqind në vitin 2014.

Në baza gjinore, tregu i punës në Kosovë vazhdon të karakterizohet me një shkallë veçanërisht të lartë të papunësisë tek femrat. Në vitin 2014, shkalla e papunësisë tek femrat ishte 41.6 përqind (33.1 përqind tek meshkujt), përderisa sipas grup-moshave, janë femrat e reja që kanë shkallën më të lartë të papunësisë (rreth 71.7 përqind). Përqindja e femrave të reja të papuna (15-24 vjeç) në papunësinë e përgjithshme ishte 33.9 përqind në vitin 2014 (26.2 përqind tek meshkujt në grupmoshën e njëjtë).

Edukimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës në Kosovë. Sipas ASK-së, shkalla e papunësisë ishte më e larta për personat e pashkolluar (rreth 65 përqind), ndërsa më e ulët për personat që kishin të përfunduar arsimin terciar (15 përqind).


Një ndër karakteristikat më shqetësuese të tregut të punës në Kosovë mbetet edhe karakteri afatgjatë i papunësisë. Në vitin 2014 është evidentuar një rritje e shkallës së papunësisë afatgjatë në 73.8 përqind (68.9 përqind në vitin 2013), indikator që përfshinë punëkërkuarit e regjistruar që konsiderohen të jenë të papunë për një periudhë më të gjatë kohore se sa 12 muaj.

Në vitin 2014, nga popullata joaktive prej 702,238 persona, 128,400 persona nuk kërkonin punë si pasojë e pritjeve se ata nuk do gjejnë punë. Kategoria e klasifikuar si punëkërkuar të "dekurajuar" përbën 10.7 % të popullsisë në moshë pune në Kosovë, përderisa niveli i dekurajimit është më i lartë tek femrat se te meshkujt (13.1% krahasuar me 8.2%). Megjithatë, shkalla e dekurajimit, që në një formë reflekton edhe pritjet për ofertën në tregun e punës në vend, ka shënuar rënie krahasuar me vitin 2013, kur qëndronte në 13.1 përqind.

6. Sektori fiskal

Deri në shtator 2015, sektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe rritje të shpenzimeve buxhetore krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Të hyrat buxhetore⁹ shënuan rritje prej 7.9 përqind dhe arritën vlerën prej 1.039 miliardë euro, ndërsa shpenzimet buxhetore¹⁰ shënuan rritje prej 6.1 përqind dhe arritën vlerën prej 1.038 miliardë euro. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe, Buxheti i Kosovës regjistroi suficit të përgjithshëm prej rreth 0.8 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 14.8 milionë euro të shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 31).

Figura 31. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2016)


Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

6.1. Të hyrat buxhetore

Të hyrat buxhetore deri në shtator 2015 arritën vlerën bruto prej 1.066 miliardë euro. Nëse zbriten 26.9 milionë euro kthime të TVSH-së dhe tatimeve tjera nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, atëherë të hyrat buxhetore shënuan vlerën neto prej 1.039 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.9 përqind.

Të hyrat buxhetore në Kosovë përbëhen kryesisht nga të hyrat tatimore, të cilat deri në shtator 2015 kishin një pjesëmarrje prej rreth 87.9 përqind në gjithsej të hyrat buxhetore ndërsa pjesa tjetër prej 12.1 përqind janë të hyra jo-tatimore (figura 32). Të hyrat tatimore shënuan rritje për 7.9 përqind dhe arritën vlerën prej 913.8 milionë euro. Në kuadër të të hyrave tatimore, të hyrat nga tatimet kufitare shënuan rritje vjetore prej 7.3 përqind dhe arritën vlerën bruto prej 680.3 milionë euro. Nëse zbriten kthimet e doganës prej 3.8 milionë euro, atëherë të hyrat neto arritën vlerën prej 676.5 milionë euro. Në të njëjtën periudhë, të hyrat e mbledhura nga tatimet vendore arritën vlerën bruto prej 246.2 milionë euro apo 11.1 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2014. Nëse përjashtohen kthimet e administratës tatimore prej 23.1 milionë euro atëherë të hyrat neto nga tatimet vendore arritën vlerën prej 223.1 milionë euro. Në kuadër të të hyrave jo-tatimore, komponentët kryesorë janë të hyrat vetanake të komunave dhe të hyrat vetanake të nivelit qendror. Të hyrat vetanake të nivelit qendror shënuan rënie prej 14.3 përqind dhe arritën vlerën prej 28.8 milionë euro, ndërsa

Figura 32. Struktura e të hyrave buxhetore, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

⁹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve, huazimet e brendshme dhe të jashtme, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga depozitat në mirëbesim.

¹⁰ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve, pagesat e borxhit, pagesat nga depozitat në mirëbesim.

të hyrat vetanake të komunave, përjashtuar tatimin në pronë prej 14.2 milionë euro, shënuan rritje prej 2.0 përqind dhe arritën vlerën prej 24.4 milionë euro.

Në kuadër të tatimeve vendore, rritjen më të lartë e shënuan të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave (rritje prej 22 përqind), të cilat arritën vlerën prej 50.7 milionë euro. Poashtu, të hyrat nga TVSH-ja, e cila përbënë kategorinë kryesore të tatimeve vendore, shënuan rritje të konsiderueshme (rritje prej 20.6 përqind) dhe arritën vlerën neto prej 91.4 milionë euro. Edhe të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale shënuan një ngritje të lehtë prej 0.7 përqind dhe arritën vlerën prej 80.1 milionë euro (figura 33).


Performanca pozitive e tatimeve kufitare reflekton kryesisht rritjen e nivelit të importeve gjatë kësaj periudhe. Në kuadër të të hyrave kufitare, kategoria kryesore mbetet TVSH-ja, me një pjesëmarrje prej 47.9 përqind të gjithëj të hyrave kufitare. Të hyrat nga TVSH-ja e mbledhur në kufi u karakterizuan me rritje prej 4.7 përqind dhe arritën vlerën neto prej 324.2 milionë euro deri në shtator 2015 (figura 34). Të hyrat kufitare nga akciza, që në shtator 2015 kishin një pjesëmarrje prej 38.1 përqind në gjithëj të hyrat kufitare, shënuan rritje prej 13.2 përqind dhe arritën vlerën prej 257.8 milionë euro. Të hyrat nga tatimi doganor, që përfaqësojnë 14.5 përqind të gjithëj të hyrave kufitare, arritën vlerën prej 95.3 milionë euro dhe shënuan rritje prej 4.1 përqind.

6.2. Shpenzimet buxhetore

Vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore deri në shtator 2015 arriti në 1.038 miliardë euro, që paraqet një rritje prej 6.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Shpenzimet rrjedhëse, që kryesisht përbëhen nga pagat e mëditjet, mallrat e shërbimet dhe subvencionet e transferet arritën vlerën prej 813.0 milionë euro, që korrespondon me një rritje vjetore prej 9.1 përqind. Si rezultat i rritjes së pagave dhe pensione në prill të vitit 2014, pjesëmarrja e shpenzimeve rrjedhëse në gjithëj shpenzimet buxhetore, nga 76.1 përqind sa ishte në shtator 2014, ka arritur në 78.3 përqind në shtator 2015 (figura 35).


Shpenzimet qeveritare për paga e mëditje shënuan rritje vjetore prej 9.1 përqind, duke arritur në 389.9 milionë euro deri në shtator 2015. Rritja e kategorisë së pagave e mëditjeve ka ndikuar që pjesëmarrja e kësaj kategorie të arrijë në 37.5 përqind e gjithëj shpenzimeve në shtator 2015 nga 36.6 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje e lartë e kategorisë së pagave dhe mëditjeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2014 është për shkak se vendimi

Figura 33. Të hyrat vendore neto sipas llojeve kryesore të tatimeve, në milionë euro



Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

Figura 34. Të hyrat kufitare neto sipas llojeve të tatimeve, në milionë euro




Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

për rritjen e pagave ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2014, që do të thotë se efekti i rritjes së pagave nuk ka qenë i plotë për periudhën janar-shtator të vitit 2014. Me rritje u karakterizuan edhe kategoria e subvencioneve dhe transfereve, të cilat shënuan rritje vjetore prej 16.3 përqind dhe arritën vlerën prej 292.4 milionë euro deri në shtator 2015. Në kuadër të subvencioneve dhe transfereve, kategoria kryesore është ajo e pensioneve, e cila shënoi rritje prej 15 përqind dhe arriti në 166.4 milionë euro. Përveç pensioneve, me rritje u karakterizuan edhe subvencionet për bujqësinë, të cilat deri në shtator 2015 arritën në 29.2 milionë euro nga 11.7 milionë euro sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e kategorisë së subvencioneve dhe transfereve në gjithsej shpenzimet është rritur për 3.4 pikë përqindje dhe ka arritur në 29.4 përqind të gjithsej shpenzimeve. Në anën tjetër, shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe shpenzimet e ndryshme komunale (rryma, uji, mbeturinat, etj.), kishin vlerën prej 130.7 milionë euro, që përkon me një rënie vjetore prej 3.9 përqind, gjë që ka ndikuar që edhe pjesëmarrja e kësaj kategorie në gjithsej shpenzimet të zvogëlohet nga 13.9 përqind sa ishte në shtator 2014 në 12.6 përqind në shtator 2015.

Deri në shtator 2015, shpenzimet qeveritare për investime kapitale shënuan vlerën prej 212.8 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 4.2 përqind. Rënia e investimeve kapitale kryesisht i atribuohet zvogëlimit të shpenzimeve të parapara për investime publike, si rezultat i rritjes së shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë të cilat e kanë kufizuar hapësirën për investime kapitale. Shpenzimet kapitale të cilat historikisht kanë qenë kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej shpenzimet, në dy vitet e fundit kanë kaluar në vendin e tretë pas kategorisë së pagave e mëditjeve dhe kategorisë së subvencioneve e transfereve. Investimet kapitale e kanë zvogëluar pjesëmarrjen nga 22.7 përqind e gjithsej shpenzimeve në shtator 2014 në 20.5 përqind në shtator 2015.

Figura 35. Struktura e shpenzimeve buxhetore, në milionë euro




Burimi: MF dhe kalkulimet e BQK-së (2016)

6.3. Borxhi publik

Deri në shtator 2015, stoku i borxhit publik arriti vlerën prej 719.5 milionë euro që është për 30.6 përqind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 12.5 përqind nga 10.2 përqind sa ishte në shtator 2014. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Sipas vlerësimeve të FMN-së, mesatarja e borxhit publik në vendet e EJL-së në vitin 2015 ka arritur normën prej rreth 60.5 përqind të BPV-së. Gjithashtu, borxhi publik në raport me BPV-në në

Figura 36. Borxhi publik, në milionë euro



Burimi: MF (2016)

vendet e rajonit është rritur për mesatarisht 2.9 pikë përqindje gjatë vitit 2015, ndërsa në Kosovë rritja e borxhit publik në raport me BPV-në deri në shtator ishte 2.3 pikë përqindje.

Në të kaluarën, pjesa dërmuese e borxhit publik ishte borxh i jashtëm. Mirëpo, si rezultat i rritjes më të shpejtë të borxhit publik të brendshëm, pjesëmarrja e borxhit të jashtëm dhe atij të brendshëm në strukturën e përgjithshme të borxhit publik është përafëruar (figura 36). Në shtator 2015, rreth 51.0 përqind e gjithsej borxhit publik ishte borxh ndërkombëtar, që kryesisht i përket Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (49.3 përqind e gjithsej borxhit publik ndërkombëtar) dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (36.1 përqind e gjithsej borxhit publik ndërkombëtar). Pjesa tjetër prej 49.0 përqind e borxhit publik është borxh i brendshëm, që kryesisht përbëhet nga borxhi i qeverisë ndaj bankave komerciale (71 përqind e gjithsej borxhit publik të brendshëm) dhe fondeve pensionale (22 përqind e gjithsej borxhit publik të brendshëm).

Sa i përket borxhit të brendshëm publik, ai i përket në tërësi nivelit qendror, ndërsa niveli komunal ende nuk ka filluar një proces të tillë të huamarrjes. Sipas kalendarit të publikuar nga Ministria e Financave, gjatë periudhës janar-shtator 2015 janë mbajtur 16 ankande për emetimin e letrave me vlerë, nga të cilat njëmbëdhjetë (11) për emetimin e bonove të thesarit dhe katër (4) për emetimin e obligacioneve qeveritare. Në këto ankande të letrave me vlerë janë emetuar 295.5 milionë euro vlerë nominale, krahasuar me 302.2 milionë euro vlerë nominale emetuar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Shuma e emetuar e letrave me vlerë në formë të obligacioneve për periudhën janar-shtator 2015 është rritur në 84.9 milionë euro nga 37.0 milionë sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Krahas rritjes së emetimit të obligacioneve, emetimi i bonove të thesarit tregoi rënie nga 265.17 milionë euro në 213.6 milionë euro deri në shtator 2015. Kjo gjë reflekton orientimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës drejt rritjes së huamarrjes afatgjatë, kur në këtë vit për herë të parë janë emetuar dy obligacione qeveritare me afat maturimi 3 dhe 5 vjeçar. Sidoqoftë, pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej shumën e emetuar nga janari deri në shtator 2015 e kanë bonot e thesarit me maturitet 364 ditë.


7. Sektori bankar

Sistemi financiar në vend është karakterizuar me zgjerim të vëllimit të aktivitetit dhe përmirësim të performancës financiare në vitin 2015. Gjithsej asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 4.8 miliardë euro deri në shtator të vitit 2015, duke shënuar rritje vjetore prej 7.1 përqind, rritje që kryesisht i atribuohet rritjes së aseteve të bankave komerciale dhe fondeve pensionale. Në të njëjtën periudhë, sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar kishin kontribut të vogël në rritjen e përgjithshme të aseteve të sistemit financiar.

Në kuadër të sektorit bankar, si segmenti kryesor në sistemin financiar në vend, kreditë vazhdojnë të jenë kategoria kryesore me pjesëmarrje prej 60 përqind në gjithsej asetet e sektorit në shtator 2015. Dinamika e aktivitetit kreditues në vend vlerësohet të ketë qenë në nivelin më të lartë në tri vitet e fundit. Në shtator të vitit 2015, vlera e gjithsej kredive arriti në 2.0 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 7.5 përqind (3.2 përqind në shtator 2014) (figura 37).


Trendi i përshpejtuar i rritjes së kreditimit që karakterizoi nëntëmuorin e parë të vitit 2015 i atribuohet ofertës më të lehtësuar kredituese të bankave si dhe kërkesës më të lartë për kredi si nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) ashtu edhe ekonomitë familjare. Për periudhën mars-shtator 2015, bankat deklaruan standarde më të lehtësuara kreditore veçanërisht për NVM-të dhe për kreditë konsumuese në kuadër të kredive për ekonomitë familjare, përderisa sipas maturitetit, bankat deklaruan standarde më të lehtësuara kreditore për kreditë afatgjata. Bazuar në Anketën e Kreditimit Bankar, faktorët kryesorë që shpjegojnë politikën më të lehtësuara bankare të kreditimit gjatë periudhës mars-shtator 2015 ishin pozita e kënaqshme e likuiditetit të bankave komerciale, konkurrenca në sistemin financiar dhe përmirësimi i cilësisë të kredisë (KJP-ve). Bankat raportuan përgjithësisht rritje të kërkesës për kredi gjatë kësaj periudhe, veçanërisht nga NVM-të, përderisa në kuadër të ekonomive familjare, bankat raportuan për kërkesë më të lartë për kredi konsumuese. Sipas maturitetit, kërkesë më të lartë raportuan bankat për kreditë afatgjata. Rritja e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet raportohet të jetë ndikuar pozitivisht nga rritja e kërkesës për financim të investimeve fikse të ndërmarrjeve, për financim të kapitalit punues dhe ristrukturim të borxhit, përderisa kërkesa e rritur nga ekonomitë familjare kryesisht i është atribuar zhvillimeve në

Figura 37. Norma e rritjes së kredive sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 38. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

tregun e pasurive të paluajtshme dhe rritjes së besueshmërisë së konsumatorëve dhe rritjes së shpenzimeve tjera për konsum.

Megjithatë, përkundër ritmit të përshpejtuar të rritjes së kreditimit, raporti i kredive të sektorit bankar ndaj BPV-së në vitin 2015 ishte rreth 35 përqind, që është më i ulët se sa mesatarja e vendeve të rajonit që qëndroi në rreth 48 përqind. Kjo sugjeron se, në raport me madhësinë e ekonomisë, vazhdon të ketë hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditor nga sektori bankar. Përveç nevojës për rritje të mëtutjeshme të kreditimit, sfida tjetër konsiderohet edhe nevoja për ndryshimin e strukturës së kredive kundrejt sektorëve që kanë peshë më të madhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, përdërisa sektorë të rëndësishëm siç janë prodhimi dhe bujqësia kanë pjesëmarrje të ulët në strukturën e përgjithshme të portfolios kreditorë të sektorit bankar. Sidoqoftë, me gjithë pjesëmarrjen e ulët në gjithsej kreditë, sektori i bujqësisë dhe prodhimit u karakterizuan me rritjen më të lartë të kredive prej 17.4 përkatësisht 10.1 përqind në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Në këtë periudhë, rritje të kreditimit shënuan edhe sektori i tregtisë dhe energjetikës (7.0 përqind përkatësisht 5.7 përqind) (figura 38).


Në anën tjetër, sektori i ndërtimitarisë është karakterizuar me rënie të kreditimit për të tretin vit radhazi. Deri në shtator 2015, kreditë për sektorin e ndërtimitarisë shënuan një rënie vjetore prej 11.1 përqind. Rënia e kreditimit për sektorin e ndërtimitarisë mund ti atribuohet rënies së aktivitetit të përgjithshëm në këtë sektor veçanërisht në vitin 2014 dhe tremujorin e parë të vitit 2015. Sipas ASK-së, sektori i ndërtimitarisë u karakterizua me rritje të konsiderueshme të aktivitetit në tremujorin e dytë të vitit 2015, duke sugjeruar për rritje të mundshme të kreditimit në periudhat vijuese.

Burimi kryesor i financimit për sektorin bankar vazhdojnë të jenë depozitat, që në shtator 2015 shënuan rritje vjetore prej 5.5 përqind. Depozitat e sektorit bankar arritën vlerën prej 2.66 miliard euro në shtator të vitit 2015 dhe përfaqësuan 80 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar.

Kreditë e sektorit bankar gjatë vitit 2015 u karakterizuan me rënie të theksuar të normës së interesit, gjë që paraqet një lehtësim të rëndësishëm për qasjen individëve dhe ndërmarrjeve në

financimin bankar. Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 7.9 përqind në shtator 2015, krahasuar me 10.7 përqind sa ishte në shtator të vitit 2014 (figura 39). Zvogëlimi i kostos së financimit pritet të shërbejë si faktor i rëndësishëm për nxitjen e rritjes së konsumit dhe investimeve në ekonominë e vendit. Në anën tjetër, norma mesatare e interesit në depozita në shtator 2015 u zvogëluar në 0.9 përqind, nga 1.1 përqind sa ishte në shtator 2014. Rrjedhimisht, dallimi ndërmjet normës mesatare të interesit në kredi dhe në depozita u zvogëluar në 7 pp në shtator 2015, nga 9.7 pp sa ishte në shtator 2014.

Figura 39. Mesatarja vjetore e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Performanca financiare e sektorit bankar u përmirësua dukshëm, duke shënuar fitim neto në vlerë prej 69.3 milionë euro në shtator 2015, përderisa neto profiti i shënuar në shtator 2014 ishte 46.9 milionë euro (figura 40). Përmirësimi i performancës financiare të sektorit bankar në dy vitet e fundit është kryesisht rrjedhojë e zvogëlimit të theksuar të shpenzimeve, veçanërisht atyre për provizione (mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë) dhe shpenzimeve të interesit në depozita, përderisa të hyrat e sektorit bankar shënuan rënie të lehtë.

Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë si rezultat i menaxhimit të mirë të rreziqeve bankare. Në shtator 2015, treguesit kyç të likuiditetit u karakterizuan me rritje, gjë që ndikoi në përmirësimin e mëtejshëm të pozitës së likuiditetit të sektorit bankar. Gjithashtu, sektori bankar është karakterizuar në vazhdimësi me nivel të lartë të kapitalizimit, duke tejkaluar kërkesat minimale rregullative. Gjatë vitit 2015, ekspozimi i sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut kreditor ka treguar tendencë rënëse, ku raporti i kredive joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive ka zbritur në 6.8 përqind në shtator 2015 nga 8.5 përqind në shtator 2014 (figura 41).

Figura 40. Treguesite profitabilitetit





Figura 41. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2016)

8. Sektori i jashtëm

Deri në shtator të vitit 2015, sektori i jashtëm në Kosovë u karakterizua me përkeqësim të pozicionit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, përderisa në të njëjtën periudhë, pozicioni i llogarisë financiare u përmirësua. Llogaria rrjedhëse dhe kapitale shënoi rritje të deficitit në nëntë muajt e parë të vitit 2015, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave dhe rënies së shënuar në bilancin pozitiv të llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave parësore. Në këtë periudhë, bilanci pozitiv i të ardhurave dytësore u karakterizua me rritje.


Rikuperimi i kërkesës së jashtme veçanërisht në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në disa nga vendet e eurozonës është reflektuar në rritje të eksporteve të Kosovës gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015. Gjithashtu, zhvlerësimi i Normës Reale Efektive të Këmbimit (angl. Real Effective Exchange Rate: REER) deri në shtator të vitit 2015 kundrejt vitit paraprak mund të ketë ndikuar deri në një masë në rritjen e konkurrueshmërisë së mallrave të Kosovës kundrejt vendeve të rajonit. Megjithatë, rritja e kërkesës së brendshme në vend në periudhën raportuese është përkthyer në një rritje të vlerës së gjithsej importeve, duke ndikuar kështu në rritjen e deficitit tregtar. Në kuadër të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale, llogaria e shërbimeve u karakterizua me zvogëlim të bilancit pozitiv në nëntë muajt e parë të vitit 2015, kryesisht si pasojë e rritjes më të shpejtë të importeve të shërbimeve kundrejt rritjes më të ngadalshme të eksporteve. Në kuadër të të ardhurave primare dhe sekondare, të hyrat nga kompenzimi i punëtorëve dhe të remitancat e pranuar në vend shënuan rritje në periudhën raportuese, duke kontribuar kështu në ngushtimin e deficitit në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale.

Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, llogaria financiare u karakterizua me përmirësim të performancës, kryesisht si rezultat i rritjes së bilancit të investimeve të huaja direkte dhe investimeve tjera, përderisa investimet portfolio u karakterizuan me zvogëlim të bilancit.

8.1. Llogaria rrjedhëse dhe llogaria kapitale

Dinamika e zhvillimeve në llogarinë rrjedhëse të Kosovës vazhdon të përcaktohet kryesisht nga zhvillimet në bilancin tregtar të vendit. Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, pozicioni i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në Kosovë u përkeqësua si pasojë e rritjes së deficitit në tregtinë e mallrave, përderisa bilanci pozitiv në tregtinë e shërbimeve dhe të kategorive siç janë të ardhurat primare dhe sekondare vazhdojnë të kontribuojnë në

ngushtimin e këtij deficiti (figura 42). Deficiti prej 308.2 milionë euro i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka arritur në rreth 7.3 përqind të BPV-së deri në shtator 2015, nga rreth 6.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse gjatë kësaj



Burimi: BQK (2016)

periudhe ishte kryesisht pasojë e rritjes së deficitit tregtar, si dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të llogarisë së shërbimeve, të ardhurave parësore dhe dytësore.¹¹

Bilanci i llogarisë kapitale¹² u zvogëlua në 1.8 milionë euro deri në shtator 2015, nga 5.5 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, gjë që i atribuohet rritjes më të lartë të daljeve të transfereve kapitale, kundrejt hyrjeve të shënuara në këtë kategori.

Mallrat dhe shërbimet

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje të aktivitetit tregtar në nëntë muajt e parë të vitit 2015, gjegjësisht me rritje të vlerës së gjithsej eksporteve dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve. Vëllimi i shkëmbimeve tregtare të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet Kosovës dhe sektorit të jashtëm shënoi rritje për 4.1 përqind në periudhën raportuese. Shkalla e hapjes tregtare arriti në rreth 70 përqind deri në shtator të vitit 2015, një nivel i ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.


Vlera e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në nëntë muajt e parë të vitit 2015 shënoi një rritje vjetore prej 6.4 përqind, përderisa vlera e gjithsej mallrave dhe shërbimeve të importuara shënoi një rritje prej rreth 3.2 përqind. Në raport me BPV-në, eksporti i mallrave dhe shërbimeve të Kosovës vazhdon të mbetet në nivel të ulët prej rreth 20 përqind, përderisa raporti ndërmjet importit të mallrave dhe shërbimeve dhe BPV-së qëndroi në rreth 50 përqind.

Në nëntë e parë të vitit 2015, deficitit tregtar në mallra dhe shërbime arriti vlerën prej 1.3 miliard euro (rreth 29 përqind e BPV-së), që tregon për një rritje vjetore prej 1.1 përqind. Përkundër rritjes së eksportit të mallrave, baza ende e ulët e tyre kundrejt vlerës së importit të mallrave ka ndikuar që deficitit tregtar të shënojë rritje. Në anën tjetër, llogaria e shërbimeve u karakterizua me zvogëlim të bilancit pozitiv në periudhën raportuese, kryesisht si rezultat i rritjes më të shpejtë të vlerës së shërbimeve të importuara, kundrejt vlerës së shërbimeve të eksportuara.

Mallrat

Struktura e eksporteve të Kosovës vazhdon të dominohet nga kategoria e metaleve bazë, e cila në shtator të vitit 2015 rriti pjesëmarrjen në gjithsej eksportet në rreth 51 përqind nga 42 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 43). Vlera e gjithsej eksporteve të metaleve bazë deri në shtator 2015 arriti në 128.4 milionë euro, nga 120.0 milionë euro sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit 2014.

Figura 43. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative në milionë euro



Burimi: ASK (2016)


¹¹ Në kuadër të Bilancit të Pagesave të Kosovës, llogaria e të ardhurave parësore përfshinë kategoritë "Kompenzimi i punonjësve" dhe "Të ardhurat nga investimet". Llogaria e të ardhurave dytësore përbëhet nga "Transferet Qeveritare" dhe "Transferet Private – që dominohen nga remitencat".

¹² Llogaria kapitale paraqet të gjitha transaksionet që involvojnë pranimit ose pagesat e (1) transfertave kapitale dhe (2) transaksionet në mjetet jo prodhuese - jo financiare (siç janë patentat, dhe të drejtat e autorit).

Deficiti në llogarinë e mallrave shënoi vlerën 1.7 miliard euro deri në shtator të vitit 2015, që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind (figura 44). Rritja më e lartë e eksportit të mallrave krahasuar me importin ka ndikuar që raporti i mbulimit të importeve me eksporte të rritet në 13.1 përqind në shtator 2015, nga 12.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015, gjithsej eksportet e Kosovës shënuan vlerën prej 250.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 5.6 përqind (figura 45). Rritja e vlerës së eksportit të mallrave në nëntë muajt e parë të vitit 2015 i atribuohet kryesisht rritjes së përgjithshme të kërkesës në rajon, në vendet e BE-së dhe veçanërisht në Indi, për produktet që Kosova eksporton. Përkundër rritjes së eksporteve, raporti ndërmjet eksporteve dhe BPV-së vazhdoi të jetë i ulët, duke qëndruar në rreth 6 përqind në shtator 2015.


Rritja vjetore prej rreth 7 përqind e eksportit të metaleve bazë në nëntë muajt e parë të vitit 2015 kryesisht i atribuohet rritjes së kërkesës në vendet në të cilat Kosova eksporton këto mallra, veçanërisht në Indi, gjë që është përkthyer në rritje të sasisë së eksportuar të metaleve bazë përkundër rënies së çmimeve të këtyre mallrave në tregjet ndërkombëtare. Me rritje u karakterizuan edhe eksportet e pijeve dhe duhanit (31.4 përqind kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak), produkteve të plastikës (42 përqind) dhe eksportet e makinerive dhe pajisjeve elektrike (5.0 përqind). Rritja e eksporteve të këtyre kategorive mund ti atribuohet deri në një masë rritjes së aktivitetit në industrinë përpunuese në periudhën raportuese. Në anën tjetër, eksportet e produkteve minerale, të cilat kishin një pjesëmarrje prej 12 përqind në gjithsej eksportet, deri në shtator 2015 regjistruan rënie të vlerës në 27.4 milionë euro nga 35.5 milionë euro sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e vlerës së eksporteve të produkteve minerale në periudhën raportuese mund t'i atribuohet kryesisht rënies së vlerës së eksportit të energjisë elektrike në periudhën raportuese.

Figura 44. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2016)

Figura 45. Gjithsej importet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të naftës dhe ushqimit



Burimi: ASK (2016) . IFS dhe FAOUN

Figura 46. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2016)


Në kuadër të strukturës së eksporteve, pjesëmarrje më të lartë kanë eksportet e mallrave të ndërmjetme (rreth 79 përqind të gjithsej mallrave të eksportuara), mallra këto që u karakterizuan me një rritje të vlerës kundrejt vitit paraprak prej 0.8 përqind. Mallrat e ndërmjetme që Kosova eksporton në vendet tjera kryesisht janë pajisje industriale të papërpunuara dhe të përpunuara. Një pjesëmarrje më të ulët kanë eksportet e mallrave të konsumit (rreth 16 përqind), si dhe mallrat kapitale (3 përqind).

Vlera e gjithsej mallrave të importuara në Kosovë deri në shtator 2015 ishte 1.9 miliardë euro (rreth 45 përqind e BPV-së), që paraqet një rritje vjetore prej 2.3 përqind. Trendi i rritjes së vlerës së gjithsej importeve gjatë vitit 2015 u ndikua negativisht nga rënia e çmimeve të produkteve kryesore të importit, konkretisht produkteve minerale, produkteve ushqimore dhe metaleve (figura 46). Vlera e importeve të produkteve minerale, shënoi rënie vjetore prej 10 përqind gjatë kësaj periudhe, duke zbritur në 311.8 milionë

euro. Produktet minerale, që kryesisht dominohen nga nafta, kanë njëherësh edhe pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej importet në vend (16 përqind në shtator 2015) (figura 47). Përveç kategorisë së produkteve minerale, të gjitha kategoritë tjera të importit u karakterizuan me rritje të vlerës në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Vlera e gjithsej importeve të metaleve bazë shënoi rritje vjetore prej 10 përqind, duke arritur në 186.0 milionë euro në nëntë muajt e parë të vitit 2015. Rritja e importeve të metaleve bazë kryesisht i atribuohet kryesisht rritjes së kërkesës dhe si rrjedhojë, sasisë së importeve të metaleve të hekurit dhe artikujve të hekurit gjatë kësaj periudhe. Në anën tjetër, rritja vjetore e vlerës së importeve të produkteve kimike (7 përqind), importeve të mjeteve të transportit (19 përqind), makinerive, pajisjeve mekanike (3 përqind), dhe importeve të produkteve të tekstilit (2 përqind) deri në shtator të vitit 2015 mund t'i atribuohet deri në një masë rritjes së aktivitetit në industrinë përpunuese në Kosovë gjatë periudhës raportuese.


Në kuadër të strukturës së importeve, pjesëmarrja e mallrave kapitale prej 9 përqind mbetet e ulët, megjithëse në nëntë muajt e parë të vitit 2015 u karakterizuan me një rritje vjetore prej 4.4 përqind. Deri në shtator 2015, vlera e importit të mallrave të ndërmjetme është rritur krahasuar me vitin paraprak për 1.8 përqind, përderisa vlera e importit të mallrave të konsumit gjatë kësaj periudhe është rritur për 3.6 përqind. Mallrat e ndërmjetme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të strukturës së gjithsej mallrave të importuara në vend (rreth 50 përqind), përderisa mallrat për konsum kanë një pjesëmarrje prej rreth 36 përqind.

Figura 47. Struktura e importeve sipas klasifikimit BEC, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

Figura 48. Struktura e eksporteve dhe importeve sipas shteteve, në përqindje



Burimi: ASK (2016)

Pjesëmarrja e mbetur prej rreth 6 përqind i takon mallrave të pa kategorizuara të importit (figura 48).

Partnerët kryesor tregtarë të Kosovës në vitin 2015 vazhduan të mbesin shtetet e BE-së dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Deri në shtator të vitit 2015, rreth 31 përqind e gjithsej eksporteve të Kosovës kishin për destinacion vendet e BE-së. Në kuadër të vendeve të BE-së, eksportet kosovare ishin kryesisht të përqendruara në Belgjikë, Gjermani, Zvicër dhe Austri. Sa i përket vendeve të rajonit, Kosova vazhdon të eksportojë më shumë në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni. Një pjesëmarrje e konsiderueshme e eksporteve të Kosovës ka për destinacion edhe Indinë dhe Turqinë (figura 48). Në kuadër të vendeve të rajonit, në Shqipëri Kosova vazhdon të eksportojë kryesisht hekur dhe çelik si dhe artikuj të tyre, metale bazë, produkte të plastikës, pije, produkte minerale, etj. Në Mal të Zi dhe Maqedoni, Kosova eksporton kryesisht metale bazë, duhan, produkte të tekstilit, artikuj të letrës, artikuj të gurit dhe qeramikës, etj.


Në anën tjetër, importet me origjinë nga BE-ja përfaqësojnë rreth 42 përqind të gjithsej importeve të Kosovës. Në shtator 2015, pjesa më e madhe e importeve ka ardhur nga Gjermania, Italia dhe Greqia. Në kuadër të vendeve tjera evropiane dhe vendeve nga Azia, Kosova vazhdoi të importojë sasi të konsiderueshme të mallrave nga Turqia dhe Kina. Ndërkaq, në kuadër të vendeve të rajonit, pjesa më e madhe e importeve të Kosovës vjen nga Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria.

Sikurse në periudhat paraprake, Kosova vazhdon të importojë produktet minerale kryesisht nga Italia dhe Greqia, përderisa nga Gjermania importon makineri, pajisje mekanike dhe elektrike, mjete të transportit, produkte të plastikës, duhan etj. Nga partnerët tregtar të rajonit, gjegjësisht nga Serbia dhe Maqedonia, Kosova importon kryesisht produkte minerale, pajisje mekanike dhe elektrike, produkte të qeramikës, pije dhe produkte ushqimore, etj. Nga vendet tjera evropiane dhe Azia, konkretisht nga Turqia dhe Kina, importi përbëhet kryesisht nga produktet e hekurit dhe çelikut, pajisjet mekanike dhe elektrike, produktet e qeramikës, tekstilit, etj.

Shërbimet

Bilanci i shërbimeve deri në shtator 2015 kishte vlerën prej 265.7 milionë euro, që paraqet një rënie prej 3.9 përqind krahasuar me bilancin e shënuar në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zvogëlimi i bilancit të llogarisë së shërbimeve në këtë periudhë kryesisht reflekton rritjen më të shpejtë të pagesave të rezidentëve kosovarë ndaj jo rezidentëve, kundrejt rritjes së të hyrave nga shitja e shërbimeve ndaj jorezidentëve. Eksporti i shërbimeve gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015 arriti vlerën prej 618.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.2 përqind. Ndërsa, importi i shërbimeve arriti vlerën prej 352.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore të shpenzimeve prej 17.5 përqind.

Figura 49. Struktura e neto eksportit të shërbimeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Në kuadër të bilancit të shërbimeve, kategoria kryesore vazhdon të jetë kategoria e udhëtimit (figura 49). Deri në shtator 2015, bilanci i llogarisë së shërbimeve të udhëtimit arriti në 319.2 milionë euro, që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rritje vjetore prej 13.0 përqind. Megjithëse shërbimet e udhëtimit u karakterizuan me rritje si të eksportit ashtu edhe të importit, pesha më e lartë e eksporteve në kategorinë e udhëtimit ndikoi që bilanci i përgjithshëm i shërbimeve të udhëtimit të shënojë rritje. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit arritën vlerën prej 443.0 milionë euro, një rritje vjetore prej 15.4 përqind, dhe kryesisht përbëhen prej shpenzimeve të jorezidentëve gjatë qëndrimit në Kosovë. Në të njëjtën periudhë, pagesat për shërbimet e udhëtimit të rezidentëve kosovarë arritën vlerën prej 123.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 21.9 përqind.

Deri në shtator të vitit 2015, shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit u karakterizuan me zvogëlim të theksuar të bilancit në 1.5 milionë euro krahasuar me 24.8 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 50). Bilanci i kësaj kategorie u zvogëlua kryesisht si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit të kompanive të telekomunikimit në ekonominë e Kosovës, që mund të ketë rezultuar nga avancimi i vazhdueshëm i teknologjisë në kuptimin e ofrimit të produkteve të reja telekomunikuese që ofrohen pa pagesë.

Figura 50. Shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, bilanci pozitiv i shërbimeve të ndërtimit u karakterizua me rritje. Në këtë periudhë, bilanci i shërbimeve të ndërtimit arriti në 7.4 milion euro (3.1 milion euro deri në shtator 2014). Rritja e bilancit të shërbimeve të ndërtimit kryesisht reflekton rritjen e eksportit të shërbimeve të ndërtimit dhe rënien e importit të këtyre shërbimeve. Gjithashtu, me rritje vjetore u karakterizuan edhe shërbimet tjera të biznesit, që deri në shtator 2015 arritën vlerën prej 32.6 milion euro (12.5 milion euro deri në shtator 2014). Rritja e shënuar në bilancin e shërbimeve të tjera të biznesit ishte kryesisht rezultat i rënies më të lartë të importeve kundrejt rënies së shënuar në eksportet e shërbimeve tjera të biznesit.

Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, shërbimet e prodhimit (kryesisht shërbime rreth “mallrave për procesim” si procesimi, paketimi, etj) shënuan një rritje të konsiderueshme vjetore, megjithëse vlera e këtyre shërbimeve mbetet e ulët me një shumë prej 4.7 milion euro (2.4 milion euro në nëntë muajt e parë të vitit 2014). Bilanci pozitiv në kategorinë e shërbimeve të prodhimit, e që janë shërbime rreth mallrave të kategorizuara si mallra për procesim, shënoi rritje në nëntë muajt e parë të vitit 2015 si rezultat i rritjes më të shpejtë të eksporteve të këtyre shërbimeve kundrejt rritjes që shënuan importet.

Të ardhurat parësore

Llogaria e të ardhurave parësore deri në shtator të vitit 2015 kishte bilanc pozitiv prej 63.3 milionë euro, i cili është për 26.6 përqind më i ulët krahasuar me bilancin e vitit paraprak. Në kuadër të llogarisë së të ardhurave primare, pranimet u karakterizuan me rritje vjetore prej 4.4 përqind, duke arritur vlerën prej 168.7 milionë euro. Në anën tjetër, pagesat shënuan një rritje vjetore prej 39.8 përqind, duke arritur vlerën prej 105.4 milionë euro.

Kategoria më e madhe në kuadër të të hyrave të llogarisë së të ardhurave parësore mbeten të hyrat nga kompensimi i punëtorëve (figura 51). Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve, që kryesisht përbëhen nga të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit, deri në shtator 2015 arritën vlerën prej 159.7 milionë euro (154.1 milionë euro deri në shtator 2014).


Në anën tjetër, pagesat për kompensimin e punëtorëve që përfshijnë punëtorët jorezidentë të angazhuar në Kosovë për një periudhë më pak se një vit shënuan rënie në 3.2 milionë euro, krahasuar me 3.9 milionë euro sa ishin deri në shtator të vitit 2014.

Të ardhurat nga investimet jashtë vendit kishin një bilanc negativ prej 92.9 milionë (64.1 milionë euro deri në shtator 2014). Pranimet në kuadër të të ardhurave nga investimet u rritën në 7.6 milionë euro deri në shtator 2015 (6.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2014), përderisa pagesat rritën vlerën në 100.5 milionë euro (70.7 milionë euro në nëntë muajt e parë 2014). Të hyrat nga investimet përbëhen kryesisht nga të ardhurat që janë realizuar nga investimet e institucioneve vendore (letra me vlerë, depozita, etj.) në tregjet e jashtme, ndërkaq pagesat përbëhen kryesisht nga të ardhurat e realizuara nga investimet e kompanive të huaja që veprojnë në vend si bankat komerciale dhe ndërmarrjet e huaja që operojnë në vend. Në këtë kontekst, të hyrat nga investimet deri në shtator 2015 shënuan rritje kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave nga investimet e BQK-së në tregjet e jashtme, konkretisht rritjes së të hyrave nga investimet në depozita. Ndërkaq, rritja e pagesave në kuadër të të ardhurave nga investimet kryesisht rezultoi nga rritja e kapitalit dhe fondit të investimeve nga kompanitë në nëntë muajt e parë të vitit 2015.

Të ardhurat dytësore

Llogaria e të ardhurave dytësore, deri në shtator 2015, shënoi vlerën 876.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 0.9 përqind (figura 52). Struktura e të ardhurave dytësore vazhdon të dominohet nga transferet e sektorit privat (korporatat financiare, korporatave jofinanciare, ekonomive familjare, etj.), të cilat përfaqësuan 82 përqind e gjithë të ardhurave dytësore, përderisa pjesa e mbetur prej 18 përqind është përbërë nga transferet qeveritare. Zvogëlimi i bilancit të të ardhurave dytësore gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2015 ishte pasojë e zvogëlimit të të hyrave në kuadër të transfereve qeveritare.

Figura 51. Të ardhurat parësore, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Bilanci i transfereve qeveritare (trasfere të donatorëve, EULEX-it dhe UNMIK-ut) u zvogëluar në 156.7 milionë euro krahasuar me 231.6 milionë euro sa ishte deri në shtator të vitit 2014, kryesisht si pasojë e zvogëlimit të donacioneve.

Remitencat, si kategori që përbëjnë 74 përqind të gjithëj transfereve të sektorit privat u karakterizuan me rritje deri në shtator të vitit 2015. Remitencat e pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 568.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.5 përqind (figura 53). Rritja e remitencave në këtë periudhë mund t'i atribuohet deri në një masë rikuperimit ekonomik në eurozonë, si dhe zhvlerësimit të euros ndaj frankë s zvicerane, duke qenë se remitencat që pranohen në Kosovë vazhdojnë të vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra (36.0 përkatësisht 22.4 përqind të gjithëj remitencave që pranohen në vend). Një pjesë e konsiderueshme e remitencave dërgohet edhe nga Italia dhe Austria, që kanë pjesëmarrje prej 4.7 përkatësisht 3.6 përqind në gjithëj remitencat e pranuar në Kosovë (figura 54). Në nëntë muajt e parë të vitit 2015, vihet re një rritje e pjesëmarrjes së remitencave të pranuar nga SHBA-të në mesararisht 7.9 përqind (6.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Sa i përket kanaleve të transferimit të remitencave, rreth 27 përqind e remitencave të pranuar në Kosovë pranohen përmes sektorit bankar, ndërkaj 41 përqind pranohen përmes agjensioneve për transferimin e parave. Pjesa e mbetur e dërgesave transforehen përmes kanaleve të tjera që përfshijnë edhe kanalet joformale. Në pesë vitet e fundit, është vënë re një rritje konstante e pjesëmarrjes së remitencave të pranuar përmes sektorit bankar dhe agjensioneve për transferimin e parave, përdërisa në të njëjtën periudhë, kishte një zvogëlim të pjesëmarrjes së remitancave të pranuar përmes kanaleve tjera.


Në anën tjetër, dërgesat e jorezidentëve nga Kosovë drejtë vendeve tjera shënuan vlerën prej 43.5 milionë euro në nëntë muajt e parë të vitit 2015, që paraqet një rënie prej 19.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Figura 52. Të ardhurat dytësore, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Figura 53. Pranimet e remitencave



Burimi: BQK (2016)

Figura 54. Struktura e remitencave sipas shteteve, në përqindje



Burimi: BQK (2016)

8.2. Llogaria financiare

Llogaria financiare deri në shtator 2015 regjistroi bilanc prej -152.1¹³ milionë euro krahasuar me bilancin prej -37.6 milionë euro në shtator 2014. Asetet shënuan vlerën prej 194.5 milionë euro apo ishin më të larta për 28.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ndërsa detyrimet shënuan vlerën prej 346.7 milionë euro apo ishin më të larta për 83.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në kuadër të aseteve kategoria kryesore ishin asetet rezervë jashtë ekonomisë së Kosovës, ndërsa te detyrimet kategoria kryesore vazhdon të jetë investimet e huaja direkte në Kosovë (tabela 4).


Tabela 4. Llogaria financiare në milionë euro

Përshkrimi	Shtator 2012	Shtator 2013	Shtator 2014	Shtator 2015
LLOGARIA FINANCIARE	-74.3	-70.0	-37.6	-152.1
<i>Asetet</i>	251.2	214.2	151.2	194.5
Investimet e huaja direkte (dalëse)	11.8	21.8	16.9	20.9
Investimet portfolio	207.2	227.0	112.7	54.0
Investimet tjera	-193.0	-112.1	-2.1	-0.5
Asetet rezerve	225.2	77.6	23.8	120.1
<i>Detyrimet</i>	325.6	284.2	188.8	346.7
Investimet e huaja direkte (hyrëse)	178.8	219.6	121.7	270.4
Investimet portfolio	0.0	0.0	0.0	0.0
Investimet tjera	146.7	64.6	67.0	76.3

Burimi: BQK (2016)

Investimet e huaja direkte IHD-të e pranuar në Kosovë deri në shtator 2015 shënuan vlerën prej 270.4 milionë euro, apo 148.6 milionë euro më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2014 (figura 55). Rritja e IHD-ve është rezultat i fluksit më të lartë të hyrjes së IHD-ve ndërsa dallimi kaq i lartë me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është edhe për faktin se viti 2014 ishte karakterizuar me shpërndarje të superdividendës¹⁴ dhe me shitje të aksioneve të kompanive të huaja. Edhe investimet direkte të rezidentëve kosovarë në vende tjera ishin më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe arritën vlerën prej 20.9 milionë euro (16.9 milionë euro deri në shtator 2014). Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e patundshmëri në vendet e rajonit por edhe në Gjermani dhe Zvicër.

Figura 55. Investimet e huaja direkte, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

¹³ Bilanci negativ i llogarisë financiare nënkupton më shumë investime të realizuara në Kosovë nga jo-rezidentët krahasuar me investimet e rezidentëve kosovarë jashtë Kosovës.

¹⁴ Me superdividendë nënkuptohet dividenda e cila është më e lartë se sa fitimet e kompanisë në periudhën përkatëse. Shpërndarja e superdividendës ndikon në zvogëlimin e kapitalit aksionar, gjë e cila paraqet zvogëlim të IHD-ve.


Bilanci i investimeve direkte, shprehur si diferencë ndërmjet investimeve direkte të rezidentëve kosovarë në vendet tjera dhe IHD-ve në Kosovë, deri në shtator 2015 ishte -249.5 milionë euro ose 144.6 milionë euro më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

IHD-të në Kosovë kryesisht janë të përqendruara në sektorët e ekonomisë si patundshmëri me 54.2 përqind të gjithëj IHD-ve të realizuar deri në shtator 2015, ndërtimtari me 18.7 përqind, shërbime financiare me 15.7 përqind, transport dhe komunikim me 7.7 përqind, energjetikë me 4.2 përqind, etj. (figura 56). Siç edhe është paraqitur në figurën 57, pothuajse të gjithë sektorët kanë shënuar rritje sa i përket pranimit të IHD-ve.

Vlera e investimeve në patundshmëri ishte më e lartë për 43.5 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, investimet në sektorin financiar ishin më të larta për 11.1 milionë euro. Edhe investimet në ndërtimtari dhe industri, të cilat në vitin 2014 patën shënuar tërheqje të kapitalit (blerje të disa kompanive të huaja nga pronarët vendorë), deri në shtator 2015 kanë shënuar rritje të konsiderueshme.


Sa i përket formës së investimit, IHD-të e pranuar në Kosovë në formë të kapitalit aksionar ishin rreth 70.7 përqind, ndërsa pjesa tjetër prej 29.3 përqind në instrumente të borxhit (kredi ndërmjet ndërmarrjeve). Siç edhe shihet në figurën 58, të dy këto kategori kanë shënuar rritje të konsiderueshme të vlerës krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Konkretisht, investimet në kapital aksionar janë rritur nga 95.9 milionë euro sa ishin në shtator 2014 në 191.0 milionë euro në shtator 2015, ndërsa kreditë ndërmjet ndërmarrjeve (instrumente borxhi) janë rritur nga 25.8 milionë euro në 79.3 milionë euro.

Figure 56. Struktura e IHD-ve sipas aktiviteteteve kryesore ekonomike, në %




Burimi: BQK (2016)

Figure 57. IHD sipas aktiviteteteve kryesore ekonomike, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)


Figura 58. Investimet e huaja direkte sipas formës së investimit, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD deri në shtator 2015 (61.5 milionë euro), pasuar nga Turqia me 49.4 milionë euro, Mbretëria e Bashkuar me 32.7 milionë euro, Shqipëria me 28.8 milionë euro, Sllovenia me 25.3 milionë euro, Gjermania me 20.8 milionë euro etj. (figura 59). Pothuajse të gjitha shtetet i kanë rritur investimet e tyre në Kosovë, ndërsa investimet nga Gjermania ishin më të ulëta për 10.1 milionë euro.

Figura 59. IHD sipas shteteve kryesore, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Investimet portfolio, investimet tjera dhe asetet rezervë

Investimet portfolio jashtë vendit deri në shtator 2015 arritën vlerën prej 54.0 milionë euro, ndërkohë që në periudhën e njëjtë të vitit paraprak patën shënuar vlerën prej 112.7 milionë euro (figura 60). Viteve të fundit vërehet një rënie e investimeve portfolio jashtë ekonomisë së vendit, gjë që ndërlidhet me investimet e një pjese të kursimeve pensionale në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Pjesa më e madhe e investimeve portfolio të realizuara deri në shtator 2015 përbëhet nga investimet e bankave komerciale, ndërsa pjesa tjetër i takon Bankës Qendrore ku përfshihen edhe kursimet pensionale. Përderisa në vitin 2014 kishte një rialokim të mjeteve nga letrat me vlerë të borxhit në letra me vlerë të kapitalit, deri në shtator të vitit 2015 investimet në letra me vlerë të kapitalit janë zvogëluar për rreth 3.9 milionë euro ndërsa investimet në letra me vlerë të borxhit shënuan vlerën prej 57.9 milionë euro. Ky ndryshim i strategjisë së investimeve mund të ketë ndodhur për shkak se investimet në letra me vlerë të borxhit konsiderohen investime më të sigurta dhe janë me afat më të shkurtër të maturimit.

Figure 60. Asetet e investimeve portfolio, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Asetet në kuadër të investimet tjera, të cilat përbëhen kryesisht prej depozitave dhe kredive, u zvogëluar për 0.5 milionë euro. Ky zvogëlim i aseteve në kuadër të investimeve tjera i atribuohet zvogëlimit të depozitave, kryesisht nga bankat komerciale, të cilat deri në shtator 2015 u zvogëluar për 34.7 milionë euro. Në anën tjetër, kreditë bankare ndaj jo-rezidentëve shënuan rritje për 28.5 milionë euro. Për shkak të përmirësimit të situatës ekonomike në ekonominë globale, bankat mund të kenë zhvendosur një pjesë të investimeve të tyre nga depozita në kredi, ku përfitimet janë më të larta.

Në kuadër të investimeve tjera, detyrimet shënuan rritje prej 76.3 milionë euro. Kjo rritje e detyrimeve ishte kryesisht për shkak të rritjes së detyrimeve në formë të kredive tregtare të cilat arritën nivelin prej 32.0 milionë euro. Siç është paraqitur në figurën 61, rritja e kredive tregtare ka korrelacion mjaft të lartë me rritjen e nivelit të importeve. Edhe depozitat e jo-rezidentëve në bankat komerciale në Kosovë shënuan rritje dhe arritën nivelin prej 20.1 milionë euro. Asetet rezervë, të cilat janë të investuara

kryesisht në instrumente të tregut të parasë dhe në depozita, deri në shtator 2015 shënuan vlerën prej 120.1 milionë euro krahasuar me nivelin prej 23.8 milionë euro në shtator të vitit 2014. Asetet rezervë në formë të depozitat arritën nivelin prej 97.2 milionë euro deri në shtator 2015, ndërsa investimet në letra me vlerë të borxhit ishin rreth 22.9 milionë euro. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se në Kosovë përdoret Euro si valutë zyrtare, e cila është e pranueshme në çdo transaksion ndërkombëtar, mund të konsiderohet se asetet rezervë në Kosovë nuk kanë rëndësi të madhe në krahasim me shumicën e vendeve tjera.


8.3. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve

Pozicioni Ndërkombëtar i Investimeve (PNI)¹⁵ neto në shtator 2015 ishte pozitiv dhe kishte vlerën prej 151.3 milionë euro (figura 62). Bilanci pozitiv i PNI-së ka ndjekur trend rritës që nga vitit 2012, ku si përqindje e BPV-së nga 4.7 përqind sa ishte në shtator 2012 ka arritur në 6.8 përqind në shtator 2014, ndërsa është zvogëluar përsëri në 2.6 përqind në shtator 2015.

Stoku i aseteve të jashtme financiare të Kosovës në shtator 2015 arriti vlerën prej 4.5 miliardë euro (rritje vjetore prej 4.5 përqind). Rritjes së aseteve më së shumti i kanë kontribuar investimet tjera (kryesisht depozitat), të cilat shënuan rritje prej 6.2 përqind ndërsa investimet portfolio shënuan nivel të ngjashëm me shtatorin e vitit 2014 (figura 63).


Investimet portfolio, të cilat kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në stokun e aseteve jashtë vendit (30.1 përqind), janë të investuara kryesisht në aksione në tregjet e kapitalit (77.2

Figura 61. Kreditë tregtare dhe importet, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 62. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, në miliardë euro



Burimi: BQK (2016)


¹⁵ PNI paraqet gjendjen në fund të një periudhe të caktuar kohore të aseteve dhe detyrimeve të jashtme financiare. Gjendja në fund të periudhës është rezultat i gjithë transaksioneve që rrjedhin nga e kaluara, përfshirë edhe korrigjimet si pasojë e lëvizjeve në kursin e këmbimit për të llogaritur vlerën e mjeteve/detyrimeve financiare në ditën e raportimit apo ndryshimet në çmimin e tregut. Bilanci pozitiv i PNI-së nënkupton se shumica e mjeteve të investuara nga Kosova jashtë vendit është më e madhe se sa shumica e mjeteve të investuara nga shtetet tjera në Kosovë.

përqind), ndërsa pjesa tjetër (22.8 përqind) në letra me vlerë të borxhit. Rreth 40.7 përqind e investimeve portfolio janë të investuara në Irlandë, pasuar nga investimet në Luksemburg me 36.9 përqind, Gjermani me 5.4 përqind, etj.

Edhe stoku i investimet direkte të rezidentëve kosovar jashtë vendit shënoi rritje të konsiderueshme (18.9 përqind), mirëpo kontributi në rritjen e stokut të aseteve është më i vogël pasi që vetëm 4.3 përqind e gjithsej aseteve i përkasin kësaj kategorie. Investimeve direkte janë mbi 95 përqind të investuara në kapital aksionar dhe janë të orientuara kryesisht në blerje të patundshmërive në shtete e rajonit. Shqipëria paraqet vendin ku është investuar pjesa më e madhe e investimeve direkte nga investitorët kosovarë (22.8 përqind të gjithsej investimeve direkte), pasuar nga Gjermania (12.8 përqind), Maqedonia (7.0 përqind), etj.


Vlera e gjithsej stokut të detyrimeve të jashtme financiare të Kosovës në shtator 2015 arriti në 4.3 miliardë euro (10.8 përqind më shumë se në shtator 2014). Përderisa shumica e aseteve të Kosovës janë të investuara në instrumente borxhi, detyrimet e ekonomisë së Kosovës janë të dominuara nga IHD-të (74.2 përqind), gjë që paraqet një tipar të favorshëm struktural të detyrimeve pasi që IHD-të (përveç kredive ndërmjet kompanive) nuk hyjnë në kuadër të borxhit. Përveç se dominojnë strukturën e detyrimeve, IHD-të kanë kontribuar më së shumti në rritjen e gjithsej detyrimeve gjatë kësaj periudhe (figura 64). Stoku i IHD-ve deri në shtator 2015 ka rritur në 3.2 miliardë euro, që paraqet një rritje prej 10.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Turqia paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD (10.4 përqind e gjithsej stokut të IHD-ve), pasuar nga Gjermania (8.5 përqind), Sllovenia (7.5 përqind), Zvicra (7.4 përqind), etj.

Figura 63. Stoku i aseteve sipas llojit të investimit, në milionë euro




Burimi: BQK (2016)

Figura 64. Stoku i detyrimeve sipas llojit të investimit, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 65. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto sipas sektorëve institucional, në miliardë euro



Burimi: BQK (2016)


Sa i përket sektorëve institucional, Banka Qendrore dhe bankat komerciale kanë pasur në vazhdimësi bilanc pozitiv të pozicionit të investimeve ndërkombëtare (1.4 miliardë euro përkatësisht 472.7 milionë euro në shtator 2015), ndërsa sektorët tjerë¹⁶ dhe qeveria në vazhdimësi kanë pasur bilanc negativ (1.3 miliardë euro përkatësisht 367.2 milionë euro) (figura 65).

8.4. Borxhi i jashtëm

Borxhi i jashtëm i Kosovës, i cili përfshinë borxhin e jashtëm privat dhe borxhin e jashtëm publik¹⁷, në shtator 2015 arriti në 1.9 miliardë euro që është për 12.3 përqind më i lartë se sa në shtator 2014. Si përqindje e BPV-së, borxhi i jashtëm bruto arriti në 33.2 përqind (figura 66). Borxhi i jashtëm publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm bruto, çka reflekton nivelin e ulët të borxhit të përgjithshëm publik në Kosovë. Borxhi i jashtëm publik në shtator 2015 kishte vlerën prej 436.8 milionë euro.


Pjesa më e madhe e borxhit të jashtëm përbëhet nga huatë ndërmjet kompanive (figura 67). Kompanitë e huaja që operojnë në Kosovë i detyrohen sektorit të jashtëm me 797.7 milionë euro apo 41.6 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm. Me pjesëmarrje të konsiderueshme në gjithsej borxhin e jashtëm të Kosovës janë edhe sektorët tjerë (438.2 milionë euro ose 22.8 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm). Borxhi i jashtëm i qeverisë, në vlerë prej 367.2 milionë euro, është kryesisht borxh i trashëguar që nënkuptohet se është borxh afatgjatë dhe përbën 19.1 përqind të gjithsej borxhit të jashtëm bruto. Rreth 55.0 përqind e gjithsej borxhit publik parashihet të paguhet në një periudhë afatgjatë (mbi 5 vite), 32.1 përqind në një periudhë afatmesme (1 deri në 5 vite) dhe vetëm 13.0 përqind në një periudhë afatshkurtër (nën 1 vit). Stoku i borxhit të jashtëm bruto i sistemit bankar në shtator 2015 ishte 247.0 milionë euro ose 12.9 përqind e gjithsej borxhit të jashtëm. Ky borxh është afatshkurtër dhe pjesën më të madhe të tij e përbëjnë depozitat dhe kreditë e jo-rezidentëve. Me pjesëmarrjen më të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm është Banka Qendrore (69.5 milionë euro apo 3.6 përqind

Figura 66. Borxhi i jashtëm bruto, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

Figura 67. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve, në milionë euro



Burimi: BQK (2016)

¹⁶ Në kuadër të sektorëve tjerë përfshihen: fondet pensionale, ndihmësit financiarë, kompanitë e sigurimeve, organizatat joqeveritare, kompanitë private dhe individët.

¹⁷ Në kuadër të borxhit publik përfshihet borxhi i qeverisë dhe bankës qendrore, ndërsa në kuadër të borxhit privat përfshihen huat ndërmjet kompanive, sistemin bankar dhe sektorët tjerë.

e gjithsej borxhit të jashtëm). Detyrimet e Bankës Qendrore i përkasin kryesisht alokimeve të të Drejtave Speciale të Tërheqjes (angl. Special Drawing Rights: SDR) nga FMN-ja.

Sa i përket kreditorëve, gjithsej borxhi i jashtëm prej 1.9 miliardë euro i'u përket FMN-së me 10.6 përqind, Bankës Botërore me 10.9 përqind dhe kreditorëve tjerë (më shumë se gjysma e borxhit ndaj kreditorëve tjerë është kreditim ndërmjet kompanive) me 78.5 përqind.

Borxhi i sektorit të jashtëm ndaj ekonomisë së Kosovës në shtator 2015 ishte 3.2 miliardë euro. Këto mjete kryesisht janë fonde të investuara jashtë vendit, përfshirë mjetet e privatizimit dhe të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, të cilat janë të investuara kryesisht në formë të depozitave (82.1 përqind) dhe letrave me vlerë të borxhit (12.3 përqind).


Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2016 pritet të vazhdojnë të kenë ndikim negativ në rritjen e BPV-së. Ky ndikim negativ i neto eksporteve i atribuohet rritjes së kërkesës së brendshme e cila pritet të ndikojë në rritjen e importit. Në kuadër të mallrave, parashikimet aktuale janë se eksportet do të rriten për rreth 3.4 përqind në terma real, ndërsa importet pritet të rriten për rreth 3.7 përqind. Ky nivel më i lartë i importit të mallrave krahasuar me eksportin do të ndikojë që deficitin tregtar të mallrave të thellohet për rreth 3.8 përqind në terma real. Në anën tjetër, pozicioni tregtar pozitiv në kuadër të shërbimeve pritet të jetë i njëjtë me vitin e kaluar.

9.2. Sektori fiskal

Sipas parashikimeve të BQK-së, të hyrat buxhetore në vitin 2016 pritet të rriten për 4.9 përqind, ndërsa shpenzimet buxhetore pritet të shënojnë rritje prej 5.3 përqind (figura 70). Të hyrat buxhetore pritet të arrijnë në 1.53 miliardë euro dhe të shënojnë një ngritje nga 25.5 përqind e BPV-së në vitin e kaluar në 25.8 përqind në vitin 2016. Kjo rritje e të hyrave buxhetore pritet të jetë rezultat i efektit të plotë të pakos së re fiskale të ndërmarrë gjatë vitit 2015 por edhe i parashikimeve për rritje të aktivitetit ekonomik. Të hyrat nga tatimet kufitare parashikohet të arrijnë në rreth 975.2 milionë euro apo 3.7 përqind më shumë krahasuar me vitin 2015, ndërsa të hyrat nga tatimet vendore pritet të arrijnë në 369.9 milionë euro apo 7.7 përqind më shumë krahasuar me vitin 2015.

Shpenzimet buxhetore gjatë vitit 2016 pritet të arrijnë në 1.65 miliardë euro apo 5.3 përqind më shumë se sa në vitin paraprak, ndërsa si përqindje e BPV-së, shpenzimet buxhetore pritet të mbesin të njëjta me vitin e kaluar (27.7 përqind e BPV-së). Shpenzimet rrjedhëse parashihet të zvogëlojnë pjesëmarrjen në gjithsej shpenzimet nga 73.9 përqind sa ishin në vitin 2015 në 72.3 përqind në vitin 2016. Pagat e mëditjet si dhe subvencionet e transferet pritet të rriten me nga 2.6 përqind përkatësisht 6.1 përqind, ndërsa mallrat dhe shërbimet pritet të shënojnë rënie për 2.2 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet kapitale parashikohet të shënojnë rritje nominale për 12.4 përqind dhe, rrjedhimisht, pritet të rrisin pjesëmarrjen në gjithsej shpenzimet nga 25.3 përqind sa vlerësohet të ketë qenë në vitin 2015 në 27.0 përqind në vitin 2016.

Figura 70. Të hyrat dhe shpenzimet primare buxhetore, në milionë euro



p- parashikim i BQK-së
Burimi: MF (2016)

9.3. Sektori bankar

Norma vjetore e rritjes së kreditimit bankar në vitin 2016 pritet të jetë e ngjashme me vitin e kaluar (rreth 7 përqind) (figura 71). Lehtësimi i standardeve të kreditimit nga bankat, rënia e normave të interesit në kredi, por edhe rritja e kërkesës së përgjithshme në vend pritet të nxisin rritjen e kërkesës për kredi. Parashikimet e BQK-së për rritje të kreditimit janë gjithashtu në linjë me raportimet e bankave në kuadër të anketës së kreditimit bankar, rezultatet e së cilës sugjerojnë se do të ketë përsheptim të aktivitetit kreditor gjatë periudhave në vazhdim.


Depozitat e sektorit privat gjatë vitit 2015 pritet të vazhdojnë trendin e rritjes që i ka karakterizuar në vitet e fundit. Rritja e depozitave të sektorit privat gjatë vitit 2016 pritet të jetë rreth 5.9 përqind (figura 72). Rrjedha e pritur e depozitave është e lidhur me të ardhurat kombëtare të disponueshme të cilat pritet të rriten për 3.6 përqind në vitin 2016.

9.4. Sektori i jashtëm

Në vitin 2016, sektori i jashtëm pritet të karakterizohet me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe llogarisë financiare krahasuar me vitin e kaluar (figura 73). Vlera e deficitit të llogarisë rrjedhëse parashikohet të jetë 568.2 milionë euro apo 10.3 përqind më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Në anën tjetër, bilanci i llogarisë financiare pritet të jetë -314.8 milionë euro apo 20.3 përqind më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale pritet të jetë ekuivalent me 9.6 përqind të BPV-së në vitin 2016 (9.0 përqind në vitin e kaluar).


Në vitin 2016, vlera nominale e eksportit të mallrave pritet të arrijë në 330.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.6 përqind. Parashikimet për rritjen e eksporteve në vitin 2016

Figura 71. Norma e rritjes së kredive dhe BPV-së reale, në përqindje




p- parashikim
Burimi: BQK (2016)

Figura 72. Norma e rritjes së depozitave dhe BPV-së reale, në përqindje



p- parashikim
Burimi: BQK (2016)

Figura 73. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



p- parashikim
Burimi: BQK (2016)


kryesisht bazohen në pritjet për përsheptimin e rritjes së aktivitetit në disa nga sektorët e ekonomisë së Kosovës si bujqësia dhe prodhimi, si dhe në parashikimet për rritje të kërkesës së jashtme. Sipas parashikimeve të FMN-së, ekonomia e eurozonës pritet të shënojë rritje prej 1.6 përqind në vitin 2016 (1.4 përqind në vitin 2015), ndërsa ekonomia e Ballkanit Perëndimor pritet të shënojë rritje prej 3.3 përqind (2.5 përqind në vitin 2015). Eksporti i mallrave pritet të ndikohet negativisht nga rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, sidomos nga rënia e çmimeve të metaleve, ndërsa ndryshimet në politikën tatimore si lirimi nga TVSH-ja i linjave të prodhimit dhe makinerive që ndërlidhen me atë prodhim si dhe i pajisjeve të teknologjisë informative, pritet të nxisin investimet private të cilat do të rrisin kapacitetet prodhuese e rrjedhimisht edhe eksportin e mallrave. Përveç ndryshimeve në politikën tatimore, edhe MSA-ja paraqet mundësi për rritjen e eksportit. Me MSA-në, prodhuesit kosovar do të kenë mundësinë të importojnë makineri prodhuese nga BE-ja pa e paguar taksën doganore gjë që do të ndikojë në rritjen e konkurrueshmërisë së tyre. Po ashtu, eksportet nga Kosova do ta kenë më të lehtë qasjen në tregjet e BE-së. Përveç këtyre masave, pjesë përbërëse e MSA-së janë edhe Instrumentet e Paraantaresimit (IPA II), nëpërmjet të cilave BE-ja parasheh që të ndihmojë Kosovën në reformat e nevojshme – kryesisht në rritjen e kapaciteteve konkurruese, me rreth 645.5 milionë euro deri në vitin 2020.

Importi i mallrave pritet të shënojë vlerën 2.5 miliardë euro në vitin 2016 që paraqet rritje nominale vjetore prej 3.0 përqind (figura 74). Rritja e vlerës së gjithsej importit pritet të shkaktohet nga rritja e kërkesës së përgjithshme në vend gjatë vitit 2016. Edhe rënia e çmimeve të importit pritet të ndikojë në rritjen e sasisë së importit.

Deficitit i mallrave dhe shërbimeve pritet të jetë 1.8 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 3.0 përqind krahasuar me vitin paraprak. Kjo rritje e deficitit të mallrave dhe shërbimeve i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave prej 3.0 përqind, ndërkohë që suficiti i shërbimeve pritet të shënojë rritje prej 3.2 përqind dhe të arrijë në 341.4 milionë euro. Në vitin 2016, importi dhe eksporti i shërbimeve pritet të shënojnë rritje prej rreth 2.7 përqind përkatësisht 3.0 përqind, ku pesha më e madhe që ka eksporti në gjithsej tregtinë e shërbimeve pritet të ndikojë në rritje të suficitit të llogarisë së shërbimeve. Importi i shërbimeve pritet të arrijë në 447.4 milionë euro në vitin 2016, ndërsa eksporti i shërbimeve pritet të arrijë në 799.9 milionë euro. Rritja e importit të shërbimeve gjatë vitit 2016 pritet të gjenerohet kryesisht nga rritja e importit të shërbimeve të udhëtimit, transportit dhe shërbimeve të ndërtimit. Ndërkaq, rritja e shërbimeve të eksportit gjatë vitit 2016 pritet të gjenerohet nga rritja e eksportit të shërbimeve të udhëtimit që kryesisht paraqet shpenzimet e emigrantëve gjatë qëndrimit në Kosovë.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave dytësore në vitin 2016 pritet të shënojë suficit prej 1.15 miliardë euro që është për 0.4 përqind më shumë se sa suficiti i shënuar në vitin paraprak. Kjo rritje e suficitit i atribuohet kryesisht parashikimeve për rritje të remitencave për 3.0 përqind. Rritja e remitencave është e lidhur ngushtë me aktivitetin ekonomik të vendeve prej nga vinë remitencat. Rreth 60 përqind e remitencave vinë nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto për të

Figura 74. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



p- parashikim
Burimi: BQK (2016)

cilat FMN-ja ka parashikuar rritje të aktivitetit ekonomik për 1.6 përqind përkatësisht 1.3 përqind në vitin 2016 (1.5 përqind përkatësisht 1.0 përqind në vitin 2014). Në anën tjetër, transferet qeveritare pritet të shënojnë rënie prej 6.4 përqind.

Bilanci i llogarisë financiare pritet të arrijë nivelin prej -314.8 milionë euro apo 20.3 përqind më shumë se sa bilanci i kësaj llogarie në vitin e kaluar. IHD-të pritet të mbesin komponenta kryesore e llogarisë financiare e cila për vitin 2016 është parashikuar të karakterizohet me një rritje prej 3.9 përqind.

10. Shtojca statistikore

Tabela 1. Treguesit kryesor makroekonomik

Përshkrimi	2012	2013	2014	2015 (v)	2016 (p)
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Bruto Produkti Vendor (BPV)/1	5,058.8	5,326.6	5,567.5	5,706.8	5,939.1
Konsumi	5,320.4	5,539.4	5,855.3	5,928.9	6,094.6
Investimet	1,465.1	1,470.9	1,434.9	1,545.8	1,665.6
Neto Eksportet	-1,726.7	-1,683.6	-1,722.7	-1,767.9	-1,821.2
	<i>Ndryshimi në përqindje, në terma real</i>				
Rritja reale e BPV-së/1	2.8	3.4	1.2	3.0	3.2
Konsumi	2.6	2.2	3.7	1.8	2.1
Investimet	-12.9	-0.3	-5.0	8.3	8.6
Neto Eksportet	-12.1	-3.6	3.9	3.3	4.4
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Llogaria Rrjedhëse/2	-380.2	-339.4	-437.6	-541.1	-594.1
Importi i Mallrave	-2,332.0	-2,287.0	-2,382.9	-2,431.8	-2,504.5
Eksporti i Mallrave	281.9	291.5	324.3	322.5	330.9
Importi i Shërbimeve	-317.6	-320.3	-431.3	-435.5	-447.4
Eksporti i Shërbimeve	641.4	632.5	767.2	776.9	799.9
Remitencat/2	605.1	620.8	693.8	752.4	775.0
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Gjithsej kreditë e sektorit bankar për sektorin privat/2	1,739.5	1,785.7	1,881.3	2,018.4	2,149.7
Gjithsej depozitat e sektorit privat në sektorin bankar/2	2,115.8	2,285.9	2,377.9	2,550.4	2,701.9
	<i>Në milionë euro (vlera nominale)</i>				
Buxheti i Kosovës/3					
Gjithsej të hyrat primare dhe grantet	1,321.7	1,325.3	1,343.2	1,466.5	1,537.7
Gjithsej shpenzimet primare	1,441.0	1,485.2	1,477.3	1,565.6	1,648.1
Deficiti i përgjithshëm si % e BPV-së	-3	-3	-3	-2	-2
	<i>Ndryshimi në përqindje</i>				
Rritja ekonomike reale/4					
Globale	3.4	3.3	3.4	3.1	3.6
Eurozona	-0.8	-0.3	0.9	1.5	1.6
Vendet në zhvillim të Evropës	1.3	2.9	2.8	3.0	3.0

1/ Agjensia Statistike e Kosovës për vitet 2012-2014

2/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për vitet 2012-2014

3/ Ministria e Financave për vitet 2012-2014

4/ Fondi Monetar Ndërkombëtar për vitet 2012-2016

(v) Vlerësim

(p) Parashikim

Pjesët e hijezuara paraqesin vlerësime dhe parashikime të BQK-së

Tabela 2.1. Bilanci i pagesave, komponentët kryesorë

(Në milionë euro)

Përshkrimi	Bilanci nga llogaria rrjedhese dhe kapitale							Bilanci nga llogaria financiare					Gabimet dhe harresat
	Llogaria rrjedhëse						Llogaria kapitale	Investimet direkte	Investimet portofolio	Investimet tjera	Asetet rezervë		
	Mallrat	Shërbimet	Të ardhurat parësore	Të ardhurat dytësore									
2005	-228.7	-247.6	-1,078.5	-8.5	139.1	700.3	18.9	53.8	107.6	-17.5	-68.7	32.4	174.8
